



RAPORTI I PUNËS

JANAR-QERSHOR 2026

Kryetar
HALIL THAÇI

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS	5
Aktivitetet Kryesore të Periudhës Raportuese	5
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME.....	7
Sektori i Gjendjes Civile	7
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË (QSHQ) DHE ARKIVA	8
LOGJISTIKA.....	8
KUVENDI KOMUNAL	9
PROJEKTET E DREJTORISË SË ADMINISTRATËS.....	9
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....	10
SEKTORI I KULTURËS.....	11
BIBLIOTEKA E QYTETIT	13
Aktivitetet në fushën e sportit.....	14
Aktivitetet në fushën e rinisë	15
Bashkëpunimi institucional	15
Përfundim	16
DREJTORIA E INSPEKSIONIT	17
DREJTORIA E ARSIMIT	19
Sfidat dhe problemet e hasura	19
Gjendja e institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme (çerdhet)	21
Gjendja në fushën e burimeve njerëzore dhe ligjshmërisë.....	21
Numri i nxënësve është 4167 sipas komuniteteve:.....	21
Paralelet e ndara sipas Komuniteteve për vitin shkollor 2025-2026	21
Numri i nxënësve për vitin shkollor 2025-2026.....	23
Numri i nxënësve me nevoja të veçanta Arsimore.....	25
Numrin e nxënësve Aktual në Institucionet parafillor 2025/2026	26
Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë 2025/2026.....	27
Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë 2025/2026.....	28
Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë 2025/2026.....	29
Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2025/2026.....	30
Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2025/2026.....	32
Organizimet dhe mbajtja e testeve	33
Garat e Diturisë 2025-2026	35

Konkurset dhe rekreutimet gjatë periudhës gjashtëmujore janar- qershor 2026	43
Subvencionet e DKA-së për vitin shkollor dhe akademik 2025-2026.....	45
Planfikimi i projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe planet për vitin 2026/27.....	47
Shpenzimet buxhetore për gjashtë muaj në disa kategori.....	49
Projektet e DA 2026, kontratat e nënshkruara me Prokurimin	51
Menaxhimi i programit të Intranetit 2026	52
Marrëveshje Bashkëpunimi.....	55
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	56
SHËNDETËSIA.....	56
Edukimi Shëndetësor dhe Trajnimet (ZHVP)	60
Projektet e inicuarat përmes zyres së prokurimit:	60
MIRËQENIA SOCIALE.....	62
Të dhënat e përgjithshme për familjet dhe anëtarët në SNS.....	63
Dinamika e lëndëve (Aplikimet, Riaplikimet, Riaktivizimet dhe Ndërprerjet).....	63
Pasqyra e punës së Komisionit Mjekësor	63
Aktivitetet humanitare dhe donacionet.....	64
Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia.....	65
Aktivitetet kryesore të planifikuara për vitin 2026 janë si më poshtë:	65
Kërkesa të Trajtuara nga DSHPE	66
Kontratat e menaxhuara (nga vitet e kaluara deri në qershor 2026).....	66
Angazhimi i DSHPE përgjatë këtyre muajve Emergjencia	67
Shërbime Publike.....	68
Mirëmbajtja e Hapësirave Publike	68
DREJTORIA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT.....	69
Aktivitetet të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të drejtorisë:	69
DREJTORIA PËR BUIQËSI DHE ZHVILLIM RURAL	73
Aktivitetet e realizuara	73
DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM	75
SEKTORI PËR EKONOMI	75
Raporti i subvencioneve për periudhën Janar - Qershor 2026	80
i ndarë edhe në baza gjinore	80
SEKTORI PËR EKONOMI	85
Pasqyra e të hyrave në Sektorin e Ekonomisë gjatë 6 muajve.....	87

Punët të cilat janë kryer në Qendrën Komunale të Regjistrimit të Biznesit (QKRB)	88
SEKTORI I TATIMIT NË PRONË	89
Drejtoria e Infrastrukturës Lokale	93
1. HYRJE DHE PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE	93
2. PROJEKTET NË FAZËN E REALIZIMIT (EKZEKUTIMIT)	93
PROJEKTET E PËRGATITURA NGA DIL-i	94
3.1. Projekte për Infrastrukturën Komunale (Menaxhohen direkt nga DIL):	94
3.2. Projekte të përgatitura dhe të dorëzuara në Drejtoritë e tjera:	94
PROJEKTET E BARTURA (Nga viti paraprak).....	96
PROJEKTET NË FAZËN E PLANIFIKIMIT (Vizitat në terren)	97
PROJEKTET E PROJEKTUARA (Përmes kompanisë së projektimit)	99
DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN,PRONË,KADASTËR DHE GJEODEZI.....	100
-SEKTORI I PRONËS-	100
-SEKTORI I KADASTRIT-	103
-SEKTORI I GJEODEZISË-	104
-SEKTORI I URBANIZMIT-	107
NJËSIA E BURIME NJËROZORE	109
Zyra për Inegrimë Evropjane.....	109
ZYRA LIGJORE	111
Zyra e projekteve	116
Arritjet kryesore	116
Përfaqësimi institucional	117
Komunikimi me donatorët	117
Donacione dhe iniciativa të reja	117
Ngritja profesionale	118
Rezultatet konkrete të periudhës.....	118
Vlerësim përfundimtar	118

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

Të nderuar qytetarë të Komunës së Obiliqit,

Anëtarë të Kuvendit,

Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve, projekteve dhe rezultateve të arritura gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Qëllimi i tij është të ofrojë transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve, Kuvendit Komunal dhe të gjithë partnerëve institucionalë.

Gjatë kësaj periudhe, fokusi ynë ka qenë në përmirësimin e infrastrukturës publike, ngritjen e cilësisë së shërbimeve komunale, zhvillimin ekonomik lokal, mbështetjen e arsimit, kulturës dhe sportit, si dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve

Ky raport pasqyron angazhimet tona të përbashkëta për aktivitetet, arritjet, sfidat dhe sukseset e arritura në këtë gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

Aktivitetet Kryesore të Periudhës Raportuese

Gjatë periudhës raportuese, fokusi kryesor i punës së Komunës së Obiliqit ka qenë përmirësimi i shërbimeve publike, krijimi i kushteve më të mira për qytetarët dhe avancimi i projekteve me rëndësi strategjike për komunën.

- *Fillimi i punimeve për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) të re në Obiliq- Investim Kapital faza e parë e punimeve në vlerë 384,449.70€.*

Ky projekt paraqet një investim të rëndësishëm në sektorin e shëndetësisë dhe synon përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, krijimin e kushteve moderne të punës për stafin mjekësor dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe më të qasshme për qytetarët e Komunës së Obiliqit.

Komuna mbetet e përkushtuar që ky projekt të realizohet sipas standardeve të përcaktuara dhe brenda afateve të planifikuara.

- *Një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë kësaj periudhe ishte transferimi i shërbimit të pastrimit nga Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM- Pastrimi) në Ndërmarrjen Publike Komunale(NPL-Kastrioti). Ky proces u realizua me qëllim të rritjes së efikasitetit, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe ofrimit të një menaxhimi më të përgjegjshëm dhe më afër nevojave të qytetarëve.*

Komuna ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme organizative dhe administrative, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimit pa ndërprerje.

- *Ndaraj e bursave për 191 studentë të Komunës së Obiliqit*

- *Vazhdimi i Projektit'' Koogjenerimi –Shtrirja e rrjetit të Sistemi të ngrohjes qendrore në Obiliq .*
- *Perkrahje e familjeve atrehuese ne komunen e Obiliqit*
- *Subvencionimi i transportit publik*

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, Kryetari i Komunës së Obiliqit ka nënshkruar

- *Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës për realizimin e projektit të rehabilitimit, zgjerimit dhe asfaltimit të rrugës që lidh fshatrat Plemetin ,Hamidi , Siboc një investim me rëndësi për përmirësimin e qarkullimit dhe lidhjes ndërmjet këtyre vendbanimeve.*
- *Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës realizimin e projektit të ndriçimit publik në fshatin Hade e Re, me qëllim rritjen e sigurisë për qytetarët dhe përmirësimin e infrastrukturës publike.*
- *Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë për Komunitet dhe Kthim për asfaltimin dhe kanalizimin në rrugën “Sokoli” në Plemetin*
- *Memoradum Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujëqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ndërrmarrjen Hidroekonomike Ibër-Lepencë për Financimin e Projektit të ujitjes .*
- *Debat Publike lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029*

Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal së bashku me ju kemi arritur që planifikimin buxhetotor për vitin 2027-2029 ta realizojmë dhe buxhetin e planifikuar ta menagjojmë ne mënyrën me të mirë të mundëshem .

Të hyrat vetanake : 13.98%

Investimet kapitale: 67.73%

Buxheti :60.34%

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës në kuadër të kompetencave të saj dhe në përputhshmëri me legjislacionin dhe aktet normative në fuqi, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim të organeve të tjera të administratës, por edhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e komunës së Obiliqit.

Sektori i Gjendjes Civile

Në periudhën gjashtmujore, nga data 1 janar deri më 30.06.2026 kemi lëshuar gjithësej 11,484 dokumente të gjendjes civile.

Bashkangjitur tabela me listën e dokumenteve të lëshuar

Dokumentet e lëshuara nga Sektori I Gjendjes Civile- për përdorim të brendshëm			
Komuna Obiliq		Data prej	Data deri
		01.01.2026	30.06.2026
Lloji i dokumentit dhe numri i dokumenteve të lëshuara			
Çertifikatë e lindjes			1,980
Ekstrakt I lindjes			6,362
Çertifikatë e Shtetësisë			10
Çertifikatë e martesës			1,147
Çertifikatë e vdekjes			535
Çertifikatë vendbanimi			442
Çertifikatë e gjendjes martesore			233
Deklaratë e bashkësisë Familjare			717
Vertetim nga Arkivi			58
Totali:			11,484

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË (QSHQ) DHE ARKIVA

Është siguruar pranimi i kërkesave, orientimi i qytetarëve, shpërndarja e dokumentacionit dhe monitorimi i afateve. Dorëzimi i lëndëve për palët dhe institucionet e jashtme 310, ndërsa nga posta e jashtme i kemi evidentuar 209.

Këto lëndë kryhen përmes intranetit dhe librave përkatës, ku për periudhen raportuese paraqesim statistikën sipas programit, si më poshtë:

- Pranuar-12 lëndë;
- Në proces-1,499 lëndë;
- Të miratuara -6,715 lëndë;
- Të hedhura poshtë -3 lëndë;
- Të pezulluara -23 lëndë;
- Të ceduara -21 lëndë;
- Të anuluar -31 lëndë;
- Të përfunduara -9,822 lëndë;
- Gjithësej-18,675 lëndë;

LOGJISTIKA

Spektori i Logjistikës ka vazhduar menaxhimin e inventarit komunal dhe administrimin e pasurisë së Komunës.

Janë realizuar:

- regjistrimi i pasurisë në sistemin E-Pasuria;
- evidentimi i inventarit në sistemin SIMK;
- pranimi dhe shpërndarja e materialeve;
- furnizimi i drejtorive komunale me inventar dhe materiale administrative; mbështetje logjistike për institucionet komunale.

Të dhënat statistikore

- Numri i hyrjeve në SIMK: 204
- Vlera totale e pasurisë së regjistruar: 3,727,300.35 €

Gjithashtu janë kryer të gjitha hyrje-daljet e materialeve për administratën komunale, institucionet arsimore dhe ato shëndetësore.

KUVENDI KOMUNAL

Kuvendi Komunal në këtë gjashtë - mujor ka mbajtur 6 (gjashtë) seanca të rregullta, gjithashtu është mbajtur 1 (një) seanca e jashtëzakonshme dhe 1 (një) seanca solemne.

Komitetit për Politik dhe Financa ka mbajtur 6 (gjashtë) seanca ;

Komitetit për Komunitete ka mbajtur 4 (katër)seanca ;

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur 1 (një)mbledhje.

Gjatë periudhës raportuese janë pregaditur dhe publikuar aktet me karakter të përgjithshëm të miratuar nga Kryetari i Komunës gjithësej janë nxjerrur 112 vendime.

Gjithashtu në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme bëhet edhe përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK-se , komiteteve obligative , rregulloreve, vendimeve, konkurseve dhe materialeve tjera sipas kërkesës së drejtorive.

PROJEKTET E DREJTORISË SË ADMINISTRATËS

Sipas kontratave të AQP-së:

- Furnizim me material administrativ.
- Furnizim me material për zyrë.
- Furnizim me ujë.
- Shërbime me aparate të fotokopjimit dhe printerë për të gjitha institucionet komunale.

Ndërsa projektet e brendshme janë:

- Shërbime të avokatit.
- Shërbime të bufesë komunale.
- Mirëmbajtja e objekteve komunale.
- Renovimi i Sallës së Kuvendit.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit, Gjatë periudhës gjashtëmujore, DKRS ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve dhe projektesh në përputhje me Planin Vjetor të Punës. Aktivitetet e zhvilluara kanë përfshirë organizimin dhe mbështetjen e manifestimeve kulturore, promovimin e krijimtarisë artistike, ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore, si dhe mbështetjen e artistëve, shoqatave kulturore dhe iniciativave të ndryshme që kanë kontribuar në gjallërimin e jetës kulturore në komunë.

Në fushën e rinisë, janë ndërmarrë aktivitete të shumta me karakter edukativ, social dhe rekreativ, të cilat kanë synuar fuqizimin e të rinjve, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën publike dhe krijimin e hapësirave për zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale. Përmes bashkëpunimit me organizata, institucione arsimore dhe grupe rinore, janë realizuar projekte që kanë promovuar aktivizmin, vullnetarizmin dhe përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse.

Spektori i sportit ka vazhduar mbështetjen e klubeve sportive, organizimin e garave, turneve dhe aktiviteteve të ndryshme sportive, me qëllim promovimin e sportit, jetës së shëndetshme dhe përfshirjen e qytetarëve në aktivitete fizike. Përmes këtyre aktiviteteve është synuar avancimi i sportit lokal dhe krijimi i kushteve më të mira për sportistët dhe klubet sportive të komunës.

Ndërkaq, Biblioteka ka zhvilluar aktivitete të ndryshme kulturore, edukative dhe promovuese, duke ofruar shërbime për lexuesit dhe duke organizuar aktivitete që nxisin kulturën e leximit, edukimin e vazhdueshëm dhe qasjen në informacion. Përmes promovimeve të librave, takimeve letrare, aktiviteteve me nxënës dhe lexues të grupmoshave të ndryshme, biblioteka ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në jetën kulturore dhe arsimore të komunës.

Ky raport paraqet në mënyrë të përmbledhur aktiviteteve, angazhimet dhe rezultatet e realizuara nga sektorët e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Bibliotekës gjatë periudhës gjashtëmujore, duke reflektuar punën, përkushtimin dhe kontributin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në zhvillimin e jetës kulturore, rinore, sportive dhe edukative në komunë.

- Përgatitja dhe hartimi i Planit të Punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2026
- Formimi i Këshillit Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2026
- Përgatitja e planit të aktiviteteve të prokurimit për vitin 2026
- Takim letrar “Vjeshta Poetike” në bashkëpunim me komunitetin letrar.

- Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve monitoruese të përfituesëve nga Thirrja Publike 2025
- Përgatitja e Thirrjes Publike për subvencionim e OJQ-ve, sportive dhe kulturore për vitin 2026
- Janë realizuar takime me ministrin z.Blerim Gashani që ka rezultuar me nënshkrimin e Memorandumit të bashkëpunimit për realizimin e tri projekteve kapitale me rëndësi për zhvillimin e sportit në komunë: ndërtimi i fushës së futbollit në fshatin Rashkovë, ndërtimi i fushës së futbollit në fshatin Milloshevë dhe ndërtimi i pishinës gjysmëolimpike. Gjatë takimit u diskutua për mundësitë e mbështetjes institucionale dhe financimit të këtyre projekteve, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe krijimin e kushteve më të mira për sportistët dhe qytetarët. Po ashtu, janë shqyrtuar prioritetet dhe nevojat e komunës lidhur me zhvillimin e infrastrukturës sportive, mbështetjen e aktiviteteve kulturore dhe realizimin e projekteve me interes për qytetarët.

SEKTORI I KULTURËS

Shënimi i 18- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës

- Për nder të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo ditë me një sërë aktivitete;
- Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.
- Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Manifestim Qendror i organizuar nga DKRS-ja në Shtëpinë e Kulturës” Xhavit Haziri”, në kuadër të sëcilit u ndan mirënjohje për personalitete të shquara që dhanë kontribut në çështjen kombëtare.
- Përgatitja e Planit të Tenderimit / Projekti “Furnizim me lule për manifestimet solemne dhe përkujtimore”
- Përgatitje e projektit për ngritjen e kapaciteteve në DKRS-ë lidhur me pranimin e punëtorëve të rinj
- Organizimi i Akademisë Përkujtimore për dëshmorët e kombit dhe martirët e lirisë të rënë në mars të vitit 1998/1999.
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Poezisë.
- Organizimi i shënimit të 8 Marsit- Dita Ndërkombëtare e Gruas.

- Realizimi i vizitave në institucionet kulturore.
- Procesimi i pagesave të shërbimeve kontraktuale
- Organizimi i Akademisë Përkujtimore për dëshmorët e kombit dhe martirët e lirisë të rënë në nuajin prill të vitit 1998/1999
- Janë organizuar dhe realizuar homazhe me rastin e përvjetorëve të dëshmorëve të kombit brenda dhe jashtë Komunës së Obiliqit, me qëllim të nderimit dhe përkujtimit të jetës dhe veprës së tyre. Përmes këtyre aktiviteteve është shprehur respekti institucional dhe qytetar ndaj sakrificës së dëshmorëve, duke ruajtur dhe kultivuar kujtesën historike dhe vlerat kombëtare.
- U shënuar Dita Ndërkombëtare e Poezisë

Manifestimi Tradicional “Qershori, Muaji i Krenarisë Sonë” 11-15 qershor 2026

Në kuadër të këtij Manifestimi Tradicional u shënuan këto aktivitete:

- Në Hamidi pranë Lapidarit të Lirisë u mbajt takim informues nga përfaqësues të SHDL për nxënësit e klasëve të pesta, të Shkollave Filllore, lidhur me ngjarjen historike më 11 qershor 1998

- Janë zhvilluar homazhe pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve të Kombit në Obiliq

- Me rastin e 27-vjetorit të çlirimit të Komunës së Obiliqit, u shënuar Akademia Solemne në Shtëpinë e Kulturës ‘Xhavit Haziri’ ku mysafinë të ftuar ishin delegacioni nga Italia dhe Shqipëria. Pjesë e këtij delegacioni ishte edhe Loris Castriota Skanderbegu II, i cili konsiderohet si pasardhës i Kryetrimt Gjergj Kastrioti. Në shenjë respekti, Kryetari i Komunës z. Halil Thaçi i ndau çmimin “ Qytetar Nderi”i Komunës së Obiliqit.

Në kuadër të kësaj Akademie u mbajt edhe një program artistik ku performuan edhe Grupe këngëtaresh dhe vallëtaresh nga komunitetit arbëreshë që jetojnë në Itali.

- Me 15 qershor 2026 në fshatin Llazarevë u shënuar një tubim përkujtimor me kumtesa dhe fjalime nga studiues dhe historian të shquar nga Kosova dhe Shqipëria, tema e së cilës ishin ngjarjet historike të asaj treve.
- Komuna e Obiliqit në bashkëpunim me OJQ PLUS-CULT mbajti Tribunën Shkencore me temën “Qershoret e Krenarisë Historike” Në kuadër të tribunës u prezantuan kumtesa dhe diskutime shkencore që trajtuan ngjarje dhe personalitete të rëndësishme të historisë shqiptare, duke theksuar rolin e tyre në ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë sonë kulturore.

BIBLIOTEKA E QYTETIT

Gjatë periudhës raportuese, Biblioteka ka pritur gjithsej 706 nxënës në kuadër të vizitave të organizuara, duke kontribuar në nxitjen e kulturës së leximit dhe njohjes me fondin bibliotekar.

- Sa i përket shfrytëzimit të materialeve bibliotekare, 34 nxënës kanë qenë lexues të rregullt dhe kanë përdorur literaturën për punime shkollore, ndërsa 7 studentë kanë qenë përdorues të rregullt të bibliotekës. Gjithashtu, 18 nxënës kanë marrë libra në huazim për përdorim individual.

- Biblioteka është pasuruar edhe me donacion librash nga autori Fadil Curri, në vlerë prej 20 ekzemplarësh, duke rritur fondin bibliotekar dhe mundësitë për lexuesit.

- Në kuadër të aktiviteteve edukative dhe profesionale janë realizuar trajnime dhe takime të ndryshme, si:

- Trajnim nga Kolegji AAB mbi temën “Dhuna në Familje” (02.02.2026)
- Trajnim nga “Kërkim Shpëtim” (23.02.2026)
- Takim me Grupin Letrar të Shkollës Ekonomike (11.03.2026)
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Poezisë (25.03.2026)
- Trajnim nga “Ballkan Green Foundation” (27.03.2026)
- Vizitë nga Kopshti “Rrita Jonë” (02.04.2026)
- Trajnim nga shoqata “Areola” në bashkëpunim me shoqatën e juristëve “NORMA” (21.04.2026)
- U mbajt promovimi i librit “Vdekja e Afërdites” të autorit Betim Bregovina.
- Shkrimtari Hamit Gërguri dhuroi 24 ekzemplarë për bibliotekën tonë.

Këto aktivitete kanë kontribuar në zhvillimin edukativ, kulturor dhe social të komunitetit, duke e forcuar rolin e bibliotekës si institucion i rëndësishëm arsimor dhe kulturor në komunë.

Në raportin e gjatëmujorit paraqet në mënyrë të përgjithësuar aktivitetet, angazhimet dhe detyrat e realizuara nga Sektori i Sportit dhe Rinisë gjatë periudhës janar–qershor 2026, në përputhje me planin vjetor të punës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Obiliqit. Gjatë kësaj periudhe, sektori është angazhuar në organizimin, koordinimin dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive dhe rinore, duke synuar krijimin e mundësive më të mira për zhvillimin e sportit, promovimin e pjesëmarrjes aktive të rinjve dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat përkatëse.

Aktivitetet në fushën e sportit

Gjatë periudhës raportuese është realizuar koordinim dhe bashkëpunim i vazhdueshëm me klubet sportive që veprojnë në territorin e Komunës së Obiliqit. Përmes komunikimit të rregullt me drejtuesit e klubeve janë identifikuar nevojat, janë diskutuar planet e aktiviteteve dhe është ofruar mbështetje institucionale për organizimin dhe zhvillimin e garave sportive.

Një pjesë e rëndësishme e punës së sektorit ka qenë përgatitja dhe realizimi i procedurave administrative për ndarjen e mbështetjes financiare për klubet sportive. Në këtë proces janë përgatitur dokumentacioni përkatës, vendimet administrative dhe raportet e nevojshme, duke u siguruar që procedurat të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e përcaktuara nga komuna.

Po ashtu, është bërë monitorimi i vazhdueshëm i realizimit të aktiviteteve sportive dhe i mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve financiare të ndara për klubet sportive. Ky proces ka pasur për qëllim garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

Me rastin e festimit të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës është organizuar Turneu i Kikboksit, në të cilin morën pjesë sportistë nga klube të ndryshme. Turneu kontribuoi në promovimin e sportit, nxitjen e konkurrencës sportive dhe shënimin e kësaj feste me aktivitete sportive.

Në kuadër të kalendarit të aktiviteteve sportive komunale janë organizuar garat komunale në basketboll, ku morën pjesë nxënës dhe ekipe nga institucionet arsimore të komunës. Këto gara krijuan mundësi për zhvillimin e talentit sportiv, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe promovimin e frymës së garës së ndershme.

Gjithashtu janë organizuar garat komunale në futsal, të cilat u zhvilluan me pjesëmarrje të gjerë të të rinjve dhe nxënësve. Përmes këtyre aktiviteteve është synuar promovimi i aktiviteteve sportive dhe inkurajimi i të rinjve për një mënyrë jetese aktive dhe të shëndetshme.

Gjatë kësaj periudhe është organizuar edhe Kampionati i Kikboksit për seniorë, i cili mbledhi sportistë nga kategori të ndryshme dhe shërbeu si një mundësi për promovimin e cilësisë së sportit të kikboksit në komunë.

Me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit është organizuar Turneu i Shahut, aktivitet i cili mbledhi pjesëmarrës të grupmoshave të ndryshme dhe kontribuoi në promovimin e sporteve intelektuale dhe kulturës sportive.

Spektori ka vazhduar bashkëpunimin me federatat sportive dhe institucionet arsimore për organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta sportive, duke kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në sport dhe në zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe rekreative.

Po ashtu, është bërë përcjellja e vazhdueshme e gjendjes së objekteve sportive komunale, me qëllim identifikimin e nevojave për mirëmbajtje, përmirësimin e kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe shfrytëzimin sa më efikas të infrastrukturës ekzistuese.

Gjatë gjithë periudhës raportuese janë përgatitur raporte pune, vendime, shkresa zyrtare dhe dokumentacion tjetër administrativ, të nevojshëm për funksionimin e rregullt të sektorit dhe realizimin e detyrave të përcaktuara.

Aktivitetet në fushën e rinisë

Në fushën e rinisë, Sektori i Sportit dhe Rinisë ka organizuar dhe mbështetur aktivitete të ndryshme me karakter edukativ, kulturor dhe rekreativ, me qëllim krijimin e mundësive për përfshirjen aktive të të rinjve në jetën shoqërore të komunës.

Është zhvilluar bashkëpunim i vazhdueshëm me organizatat rinore dhe institucionet arsimore për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, duke promovuar pjesëmarrjen aktive të të rinjve dhe zhvillimin e iniciativave në interes të komunitetit.

Sektori ka mbështetur iniciativa vullnetare dhe projekte të propozuara nga të rinjtë, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete që ndikojnë në zhvillimin personal, përgjegjësinë qytetare dhe angazhimin në komunitet.

Me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve janë organizuar aktivitete festive dhe kulturore. Në kuadër të këtij programi janë shfaqur dy filma për fëmijë më 1 dhe 2 qershor 2026, duke u ofruar fëmijëve një program argëtues dhe edukativ në një ambient të përshtatshëm.

Po ashtu, në periudhën 16–18 qershor 2026 është organizuar Karnevali i Fëmijëve, i cili përfshiu aktivitete artistike, kulturore dhe argëtuese. Ky aktivitet mbledhi një numër të madh të fëmijëve dhe familjeve, duke krijuar një atmosferë festive dhe duke promovuar kreativitetin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve.

Gjatë kësaj periudhe përfaqësuesit e sektorit kanë marrë pjesë edhe në takime koordinuese me partnerë institucionalë dhe organizata joqeveritare, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe identifikimin e mundësive për realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e rinisë.

Bashkëpunimi institucional

Gjatë gjithë periudhës raportuese është zhvilluar bashkëpunim i ngushtë me klubet sportive të Komunës së Obiliqit, federatat sportive, drejtoritë komunale, institucionet arsimore, organizatat rinore dhe organizatat joqeveritare. Ky bashkëpunim ka qenë i rëndësishëm për koordinimin e aktiviteteve, shkëmbimin e përvojave dhe realizimin me sukses të projekteve dhe ngjarjeve sportive e rinore.

Përfundim

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Sektori i Sportit dhe Rinisë ka realizuar me sukses detyrat dhe aktivitetet e planifikuara, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e sportit dhe fuqizimin e aktiviteteve rinore në Komunën e Obiliqit. Përmes organizimit të garave sportive, mbështetjes së klubeve, zhvillimit të aktiviteteve për fëmijë dhe të rinj, si dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet dhe organizatat partnere, sektori ka ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën sportive dhe shoqërore. Edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdohet me angazhime konkrete për përmirësimin e kushteve për sportin dhe rininë, si dhe për realizimin e projekteve të reja në interes të qytetarëve të Komunës së Obiliqit.

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Ky raport paraqet në mënyrë të përmblëdhur aktivitetet e realizuara nga Drejtoria e Inspektionit gjatë periudhës **janar-qershor 2026**. Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar inspektime të rregullta, të jashtëzakonshme dhe inspektime sipas kërkesave/ankesave të qytetarëve. Aktivitetet kanë përfshirë inspektime në fushën e ndërtimit kolektiv, privat dhe objekteve afariste, inspektime në fushën e tregut, inspektimin e shërbimeve komunale, hapsirave publike, rrugëve, shesheve dhe parqeve, inspektimin e trafikut, autobusëve, auto-taxi-ve, reklamat si dhe punë të tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës, masat administrative të ndërmarra, bashkëpunimin me drejtoritë dhe institucione përkatës si dhe aktivitetet e tjera të realizuara në kuadër të kompetencave të Drejtorisë, me qëllim të garantimit të zbatimit të ligjit, mbrojtjes së interesit publik dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve. Gjithashtu është rritur bashkëpunimi me qytetarët, me Ministritë e linjave dhe Korporatën Elektro Energjetike-KEK.

Nr.		Gjithsej
1.	Inspektime të përgjithshme - procesverbal për kontrollin inspektues	242
2.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Ndërtim	82
3.	Inspektim me procesverbal për kushte minimale teknike-Treg	65
4.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në M. Ambientit	21
5.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues Shërbime Publik (Komunal)	66
6.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Komunikacion	8
7.	Aktvendim për ndalim të punimeve	15
8.	Aktvendim për rrënim	2
9.	Urdhër ekzekutim për rrënim	1
10.	Aktvendim për gjobë mandatore	8
11.	Shfuqizim i aktvendimit	1
12.	Plotësim-ndryshim i Aktvendimit	0
13.	Kërkesë për Gjykatë	2
14.	Kallëzim Penal	2
15.	Kërkesë nga Gjykata për plotësim të lëndës	2
16.	Asgjësim të produkteve-refuzuar	1
17.	Kërkesë për AUV-Inspektorin e Veterinës	1
18.	Raport final për Certifikata të përdorimit për objekt	2
19.	Pranim me komision për kushte higjieno- sanitare -Pëlqim	55
20.	Refuzim - komision për kushte higjieno-sanitare -Pëlqim	4
21.	Thirrje për palët	17
22.	Raporte të brendshme	6

23.	Përgjigje në kërkesë me shkrim për palën	6
24.	Përgjigje për KEK përmes e-mail	3
25.	Kërkesë për asistencë P.K-S. Policor Obiliq.	6
26.	D.SH.P.E - Njoftim	1
27.	D.SH.P.E- Kërkesë për mekanizëm për rrënim të objekteve	1
28.	D.P.U.P.K -Kërkesë	1
29.	D.M.M -Njoftim	2
30.	Kërkesa për inspektim nga palët	117
31.	Ankesa	2
32.	Të brendshme	54
33.	Në proces	11
34.	Refuzuar	6
35.	Anuluara	2
36.	Pezulluara	0
37.	Ceduar	2
38.	Miratuara	148
39.	Totali i lëndëve në Intranet	171

Me urdhërin e Kryetarit dhe iniciativën e Drejtorisë së Inspekcionit, janë ndërmarrë inspektime dhe veprime konkrete për lirim të hapsirave komunale të shfrytëzuara për kohë të gjatë pa bazë ligjore nga persona të paautorizuar, si dhe pastrimin dhe kthimin e tyre në funksion të interesit publik:

- Inspektimi dhe lirim i hapsirave të **Shtëpisë së Kulturës në Plemetin**
- Inspektimi dhe lirim i hapsirave të **Shtëpisë së Kulturës në Babimoc**
- Inspektimi dhe lirim i hapsirave të ish QTS ish- **“Nikola Tesla” në Obiliq**
- Inspektimi dhe lirim i hapsirave të **Sallës Sportive në Plemetin**
- Inspektimi dhe lirim i hapsirave të **Shtëpisë së Kulturës në Milloshevë**

DREJTORIA E ARSIMIT

Ky raport paraqet aktivitetet, angazhimet dhe rezultatet e Drejtorisë Komunale të Arsimit për periudhën gjatë muajve 11 dhjetor – qershor 2026.

Fokusi i punës ka qenë në forcimin e menaxhimit institucional, me prioritet përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore, si dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor.

Gjatë angazhimeve fillestare në terren dhe vizitave në institucionet arsimore, është konstatuar një gjendje e rënduar dhe larg standardeve të kërkuara, me mangësi të theksuara në infrastrukturë, organizim dhe funksionim të përgjithshëm. Kjo situatë ka kërkuar ndërhyrje të menjëhershme dhe një qasje më të strukturuar për adresimin e problemeve të identifikuar me mangësi të theksuara në infrastrukturë, organizim dhe funksionim të përgjithshëm. Në përgjigje të kësaj situate, janë ndërmarrë ndërhyrje të menjëhershme dhe urgjente gjatë pushimit dimëror, me qëllim përmirësimin e kushteve bazë në institucionet arsimore dhe sigurimin e një fillimi më të mirë të procesit mësimor në gjysmën e dytë të vitit shkollor.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, Drejtoria Komunale e Arsimit ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në monitorimin e punës së shkollave, bashkëpunimin me drejtuesit e institucioneve arsimore dhe koordinimin me aktetë të relevantë, me qëllim sigurimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm për nxënësit dhe stafin arsimor. Po ashtu, është kushtuar rëndësi përfshirjes dhe mbështetjes së të gjitha institucioneve arsimore në komunë, duke synuar trajtim të barabartë dhe funksionim efikas të sistemit arsimor. Ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të punës së realizuar gjatë këtij tremujori, duke përfshirë aktivitetet kryesore, arritjet dhe sfidat e hasura.

Sfidat dhe problemet e hasura

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar sfida të shumta në institucionet arsimore, një pjesë e mirë e shkollave janë gjetur në gjendje jo të mirë, me dëmtime të hapësirave të brendshme dhe të jashtme infrastrukturore, si dhe mungesë të sistemeve funksionale të ngrohjes, duke ndikuar në zhvillimin normal të procesit mësimor.

Gjatë inspektimeve të realizuara nga inspektorati komunal (22 dhjetor 2025), u pa për së afërmi gjendja në shkollë ku është konstatuar gjendje e rënduar infrastrukturore në disa objekte shkollore. Gjendja është përkeqësuar edhe më tej si pasojë e reshjeve të shumta të shiut dhe vërshimeve, të cilat kanë shkaktuar dëmtime shtesë në hapësirat shkollore. Këto rrethana kanë ndikuar drejtpërdrejt në vështirësimin e zhvillimit normal të procesit mësimor.

Në përgjigje të kësaj situate, gjatë muajit janar, në periudhën e pushimit dimëror janë ndërmarrë masa emergjente për sanimin e dëmeve dhe rikthimin e funksionalitetit të objekteve shkollore. Kjo ndërhyrje u bë e domosdoshme, pas konstatimit të një gjendjeje të rënduar në disa objekte shkollore, ku objektet shkollore ishin jo funksionale .

- Ndërhyrjet në sanimin e kulmit në SHMLP “Pandeli Sotiri” Obiliq i Vjetër
- Ndërhyrje në sanimin e kulmit në SHMLP “Ismail Dumoshi” në Obiliq
- Rregullimi i tavanit në SHMLP “Ismail Dumoshi” në kabinetin e lëdës së Kimis
- Ndërhyrje në sanimin e kulmit në SHFMU “Hasan Prishtina” në Milloshevë
- Ndërhyrje në sanimin e kulmit në Gjimnazin “17 Shkurti” në Obiliq

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë realizuar një sërë intervenimesh të tjera në shkolla, përfshirë, zgjidhjen e problemeve me furnizimin me ujë në hapësirat sanitare, si dhe ndërhyrje të ndryshme teknike dhe në mirëmbajtje. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre aktiviteteve është realizuar përmes angazhimit vullnetar, në bashkëpunim me stafin përgjegjës dhe palët relevante

Regullimi i sistemit të ujërave nga vershimet si dhe nyjes sanitare në SHFMU “Hasan Prishtina” në Milloshevë dhe SHFMU “Ibrahim Rugova”

Gjatë muajit janar, brenda periudhës së pushimit dimëror, është realizuar një ndërhyrje emergjente për sanimin dhe funksionalizimin e sistemeve të ngrohjes në institucionet shkollore. Kjo ndërhyrje u bë e domosdoshme pas konstatimit të një gjendjeje të rënduar në disa objekte shkollore, ku sistemet e ngrohjes rezultojnë jashtë funksionit ose me defekte serioze.

Sanimet u bënë në shkollat:

- Shfmu “Hasan Prishtina”,
- Shfmu “Ibrahim Rugova”,
- Shfmu “Fazli Grajcevc”
- Shfmu “Ibrahim Rugova”
- Mazgit i Epërm Kryshevc Palaj.

Poashtu u interevenua në sistemin e ventilimit dhe pjesë të dëmtuara të objekteve: elemente të kulmit dhe oxhak, saldime në gypat për ngrohje.

Gjatë pushimit dimëror në shkollën Ibrahim Rugova si dhe në “Mazgit të Epërm” u realizuan punime për sanimin dhe rregullimin e ambientit shkollos. Këto ndërhyrje u bënë me qëllim përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor dhe sigurimin e një mjedisi më të përshtatshëm për nxënësit dhe stafin.

Në kuadër të investimeve për rritjen e efikasitetit energjetik dhe përmirësimin e kushteve në institucionet parashkollore, më 7 janar 2026 janë vendosur panele solare në çerdhen në Milloshevë dhe “Rita Jonë” në Obiliq.

Është rregulluar salla e sportit në SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Gjatë renovimit është vendosur dysHEME e re dhe janë përmirësuar kushtet për nxënësit dhe stafin e shkollës.

Gjendja e institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme (çerdhet)

Që nga 1 janari 2026 në çerdhën në Milloshevë pagesat janë rregulluar sipas ligjit, Gjithashtu, kuzhina e çerdhes, e cila më parë nuk ishte funksionale, është rregulluar dhe tashmë është plotësisht në funksion, duke siguruar përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit për fëmijët sipas standardeve të përcaktuara.

Gjendja në fushën e burimeve njerëzore dhe ligjshmërisë

Drejtorja e Arsimit gjatë kësaj periudhe i ka kryer punët dhe detyrat duke u bazuar në planin e punës për vitin 2026 dhe detyrat e tjera, të cilat janë marrë nga MASH. Janë mbajtur takimet e rregullta me Bordin e Drejtorëve Komunal, drejtorët e Institucioneve Arsimore, punëtorët e DA-së dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Organizimi i procesit mësimor në gjysmëvjetorin e parë dhe të dytë

Viti i Ri shkollor 2025-2026, gjysmëvjetori i parë ka filluar më 1 shtator 2025 dhe ka përfunduar më 24 dhjetor 2025, Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 8 janar dhe ka përfunduar më 14 maj 2026 për klasët e XII-ta, më 5 qershor për klasët e IX, X, XI dhe më 19 qershor 2026 për klasët I-VIII dhe fëmijët parafillor.

Numri i nxënësve është 4167 sipas komuniteteve:

Komuniteti	Nr.nxënësve
Shqiptarë	3505
Boshnjakë	2
Ashkalinjë	201

Paralelet e ndara sipas Komuniteteve për vitin shkollor 2025-2026

Paralelet	Gjuhë Shqipe	Parafillor	Niveli I-V	Niveli VI-IX	Niveli X, XI, XII
Numri i paraleleve	218	19	94	74	31

Paralelet	Gjuhë Serbe	Parafillor	Niveli I-VIII	Niveli shkolla e mesme 1-4
Numri i paraleleve	35	2	25	8

Numri i nxënsëve për vitin shkollor 2025-2026

Institucioni Arsimor - Vendi		Shqiptarë			Boshnjakë			Ashkalinjë			Serb			Romë			Gjithsej		
		M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T
IP “Rrita jonë	Obiliq	47	34	81	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	47	34	81
IEFH - Milloshevë	Milloshevë	50	55	105	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	50	55	105
IEFH - Mazgit	Mazgit	46	57	103	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	46	57	103
SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Obiliq	453	438	891	1	1	2	11	12	23	-	-	-	-	-	-	465	451	916
SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Mazgit i ulët	83	67	150	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	83	67	150
SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Mazgit i epërm	100	100	200	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	100	100	200
SHFMU “Pandeli Sotiri”	Obiliq i vjetër	81	85	166	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	81	85	166
SHFMU “Pandeli Sotiri”	Plemetin	23	9	32	-	-	-	64	67	131	4	4	8	-	-	-	91	80	171
SHFMU “Hasan Prishtina”	Milloshevë	267	245	512	-	-	-	9	7	16	-	-	-	-	-	-	276	252	528
SHFMU “Hasan Prishtina”	Raskovë	35	28	63	-	-	-	2	1	3	-	-	-	-	-	-	37	29	66

SHFMU “Naim Frashëri	Breznicë	88	84	172	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	88	84	172
SHFMU “Naim Frashëri	Kozaric	31	32	63	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	31	32	63
SHFMU “Fazli Grajqevci”	Palaj	20	26	46	-	-	-	10	11	21	-	-	-	-	-	-	30	37	67
SHFMU “Fazli Grajqevci”	Lajthishtë	37	32	69	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	37	32	69
SHFMU “Fazli Grajqevci”	Hade e re	23	10	33	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	23	10	33
SHFMU “Migjeni”	Siboc	56	50	106	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	56	50	106
SHFMU “Migjeni”	Graboc	11	12	23	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	11	12	23
SHFMU “Abduhrramon Gërguri”	Dardhishtë	50	53	103	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	50	53	103
SHMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	233	76	309	-	-	-	4	3	7	-	-	-	-	-	-	237	79	316
Gjimnazi “17 Shkurti”	Obiliq	98	180	278	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	98	180	278
SHM “Sveti Sava”	Plemetin	-	-	-	-	-	-	-	-	-	22	40	62	30	31	61	52	71	123
SHF “Sveti Sava”	Plemetin	-	-	-	-	-	-	-	-	-	20	33	53	100	82	182	120	115	235
SHF “Milan Rakiq”	Babimoc	-	-	-	-	-	-	-	-	-	32	25	57	-	-	-	32	25	57
SHF “Dosidej Obranoviq	Palaj	-	-	-	-	-	-	-	-	-	20	16	36	-	-	-	20	16	36
Gjithsej:		1823	1673	3505	1	1	2	100	101	201	98	118	216	130	113	243	2161	2006	4167

Numri i nxënësve me nevoja te veçanta Arsimore

Institucioni Arsimor	Vendi	Numri i fëmijëve		Gjithsej
		F	M	
IP “Rrita jonë”	Obiliq	/	/	/
IEFH - Milloshevë	Milloshevë	3	2	5
IEFH - Mazgit	Mazgit	/	/	/
SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Obiliq	11	14	25
SHFMU “Pandeli Sotiri”	Obiliq i vjetër	/	/	/
SHFMU “Hasan Prishtina”	Milloshevë	2	9	11
SHFMU “Naim Frashëri	Breznicë	/	/	/
SHFMU “Fazli Grajqevci”	Hade e re	2	1	3
SHFMU “Migjeni”	Siboc	/	/	/
SHFMU “Abduhrramon Gërguri”	Dardhishtë	/	/	/
SHMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	/	/	/
Gjimnazi “17 Shkurti”	Obiliq	/	/	/
	Gjithsej:	18	26	44

Numrin i nxënësve Aktual në Institucionet parfillor 2025/2026

Institucioni Arsimor	Vendi	Numri i fëmijëve		Gjithsej
		F	M	
IP “Rrita jonë”	Obiliq	34	47	81
IEFH - Milloshevë	Milloshevë	48	47	95
IEFH - Mazgit	Mazgit			

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë 2025/2026

Arsimi fillor 1-5

Klasa	Nr.paraleleve	Nr.nxënësve	Suksesi Pozitiv										Gjithsej me nota të panjafueshme		Të pa notuar		Numri i mungesave		
			Shkëlqyshëm		Sh.mire		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive						Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%							
1	19	263	192	73.00	32	12.17	27	10.27	7	2.66	258	98.1	5	1.901	0	0	2972	469	3441
2	18	281	183	65.12	47	16.73	35	12.46	10	3.56	275	97.86	6	2.135	0	0	3016	346	3362
3	19	259	153	59.07	50	19.31	42	16.22	10	3.86	255	98.46	4	1.544	0	0	3471	810	4281
4	19	309	154	49.84	66	21.36	72	23.30	14	4.53	306	99.03	2	0.647	1	0.3	4653	1192	5845
5	19	283	135	47.70	77	27.21	49	17.31	11	3.89	272	96.11	11	3.887	0	0	3464	4173	7637
Gj	94	1395	817	58.57	272	19.50	225	16.13	52	3.73	1366	97.92	28	2.007	1	0.1	17,576	6990	24,566

Nota mesatare 4.29

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë 2025/2026

Arsimi i mesëm i ulët 6-9

Klasa	Nr.pareleleve	Nr.nxënësve	Suksesi Pozitiv										Suksesi i pamjaftushëm										Numri I mungesave		
			Shkëlqyshëm		Sh.mire		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftushme		Me 2 nota të pamjaftushme		Me 3 nota e më shumë pamjaftushme		Gjithësej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
6	19	279	90	32	64	22.94	50	18	7	2.51	21	75.63	34	12	19	7	14	5.02	67	24.01	1	0.4	5028	2121	7149
7	18	308	61	20	57	18.51	53	17	7	2.27	17	57.79	39	13	21	7	69	22.40	12	41.88	1	0.3	6336	2039	8375
8	18	331	69	21	67	20.24	46	14	12	3.63	19	58.61	52	16	19	6	65	19.64	13	41.09	1	0.3	7293	2487	9780
9	19	286	57	20	70	24.48	50	17	7	2.45	18	64.34	25	9	13	5	64	22.38	10	35.66	0	0.0	8813	2465	11278
Gj	74	1204	277	23	258	21.43	199	17	33	2.74	76	63.77	150	12	72	6	212	17.61	434	36.05	3	0.2	27470	9112	36582

Nota mesatare 2.96

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë 2025/2026

Arsimi i mesëm i lartë 10-12

Klasa	Nr.paraleleve	Nr.nxënësve	Suksesi Pozitiv										Suksesi i pamjaftushëm										Numri I mungesave		
			Shkëlqyshëm		Sh.mire		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftushme		Me 2 nota të pamjaftushme		Me 3 nota e më shumë pamjaftushme		Gjithësej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
10	10	195	14	7.2	30	15	34	17	6	3	84	43	23	12	19	10	65	33	10	5	4	2	2327	1274	3601
11	11	207	21	10.1	38	18	36	17	6	3	102	49	33	16	22	11	51	25	10	5	0	0	2542	1493	4035
12	10	189	23	12.2	44	23	32	17	7	3	106	56	29	15	15	8	35	19	79	42	4	2	3102	1517	4619
Gj	31	591	58	9.8	112	19	102	17	19	1	291	49	85	14	56	9	151	26	292	49	8	1	8018	4284	12302

Nota mesatare 2.32

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2025/2026

Arsimi fillor 1-5

Klasa	Nr.paraleleve	Nr.nxënësve	Suksesi Pozitiv										Gjithsej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Numri i mungesave		
			Shkëlqyshëm		Sh.mire		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive						Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
1	19	263	182	69.20	41	15.79	29	11.03	5	1.90	257	97.72	2	0.76	4	1.52	7511	2704	10215
2	18	279	182	65.23	54	19.35	31	11.11	10	3.58	277	99.28	0	0.00	2	0.72	4624	3026	7647
3	19	254	147	57.87	51	20.08	43	16.93	9	3.54	250	98.43	3	1.18	1	0.39	4492	1951	6443
4	19	313	163	52.08	71	22.68	54	17.25	15	4.79	303	96.81	7	2.24	3	0.96	7535	2261	9794
5	19	277	145	52.35	71	25.63	43	15.52	12	4.33	271	97.83	5	1.81	1	0.36	4456	3332	7788
Gj	94	1386	819	59.09	288	20.78	200	14.43	51	3.68	1358	97.98	17	1.23	11	0.79	28645	13274	41917

Nota mesatare 4.31

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2025/2026

Arsimi i mesëm i ulët 6-9

Klasa	Nr.pareleleve	Nr.nxënësve	Suksesi Pozitiv										Suksesi i pamjaftushëm										Numri I mungesave		
			Shkëlqysh		Sh.mire		Mirë		Mjaftuesh		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë		Me 2 nota		Me 3 nota e më shumë		Gjithësesj me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
6	19	279	101	36.20	58	20.79	73	26.16	26	9.32	258	92.47	8	2.87	7	2.51	6	2.15	21	7.53	0	0.00	720	326	10547
7	18	307	76	24.76	55	17.92	94	30.62	63	20.52	288	93.81	12	3.91	5	1.63	2	0.65	19	6.19	1	0.33	923	460	13836
8	18	328	78	23.78	68	20.73	98	29.88	51	15.55	295	89.94	18	5.49	7	2.13	7	2.13	32	9.76	1	0.30	885	502	13880
9	19	286	68	23.78	77	26.92	83	29.02	45	15.73	273	95.45	7	2.45	1	0.35	5	1.75	13	4.55	0	0.00	107	483	15557
GJ	74	1200	323	26.92	258	21.50	348	29.00	185	15.42	1114	92.83	45	3.75	20	1.67	20	1.67	85	7.08	2	0.17	360	177	53820

Nota mesatare 3.44

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2025/2026

Arsimi i mesëm i lartë 10-12

Klasa	Nr.paraleleve	Nr.nxënësve	Suksesi Pozitiv										Suksesi i pamjaftushëm										Numri i mungesave		
			Shkëlqyshëm		Sh.mire		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftushme		Me 2 nota të pamjaftushme		Me 3 nota e më shumë pamjaftushme		Gjithësesj me nota të pqamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
10	10	196	25	12.75	31	15.81	58	29.59	18	9.18	13	67.234	12	2.02	28	4.72	13	6.63	53	27.04	11	5.61	5239	2172	7411
11	11	207	33	15.94	42	20.28	75	36.23	31	14.97	18	87.143	16	7.72	5	2.41	4	1.93	25	12.07	1	0.48	4204	1686	5890
12	10	189	37	19.57	43	22.75	68	35.97	35	18.51	18	96.382	1	0.52	0	0.00	0	0.00	1	0.52	5	2.64	2179	828	3007
Gj	31	592	95	16.04	116	19.59	201	33.95	84	0.001	49	83.678	29	4.89	33	5.57	17	2.87	79	13.34	17	2.87	11,622	4686	16,308

Nota Mesatare 3.02

Organizimet dhe mbajtja e testeve

- Testi i Maturës Shtetore 2025/2026, më datë 20.06.2026, në SHMLP “Ismail Dumoshi” në Obiliq, Gjimnazi “17 shkurti” në Obiliq dhe American School of Kosova.

Rezultatet e testit të Maturës Shtetore janë publikuar me 29.06.2026.

Institucion i Edukativ Arsimor	Nr. nxënësve	Pjesëmarrësit	Kalushmëria	Përqindja	Afati I Qershorit	Afati I Korrikut
Gjimnazi “17 shkurti”	105	104	89	85.57	89	
SHMLP “Ismail Dumoshi”	116	111	46	41.44	46	
American School of Kosova	70	69	67	97.10	67	
Gjithsej	291	284	202	71.12	202	

Testi i Arritshmërisë 2025/2026, më datë 26.06.2026, ku kanë marrë pjesë 361 nxënës nga të gjitha SHFMU në Komunën e Obiliqit

Rezultatet e testit të Arritshmërisë Shtetore janë publikuar me 06.07.2026.

NR.	Institucioni Edukativ Arsimor	Pjesëmarrësit	Afati i Qershorit
1	SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	136	89
2	SHFMU “Pandeli Sotiri”	26	10
3	SHFMU “Hasan Prishtina”	58	44
4	SHFMU “Naim Frashëri”	20	14
5	SHFMU “Migjeni”	15	12
6	SHFMU “Fazli Grasjgevc	23	13
7	SHFMU “Abduhrramon Gërguri”	8	4
8	Amerika School of Kosova	75	35
	Gjithsej:	361	221

Garat e Diturisë 2025-2026

Gjatë periudhës gjashtëmujore, Drejtoria e Arsimit ka zhvilluar dhe mbikëqyrur një sërë aktivitete në funksion të përmirësimit të procesit edukativo-arsimor dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies.

Në vitin akademik 2025-2026 janë mbajtur garat e Fizikës, Matematikës, Kimisë dhe Gjuhës Shqipe në nivel të shkollave, Komunës dhe vendi.

- Në garat e Kimisë kanë marrë pjesë 22 nxënës të SHML të Komunës së Obiliqit, lista e nxënësve fitues në fazën e dytë në nivel Komune është 15 nxënës ndërsa përfaqësues në nivel vendi ishin 6 nxënës.
- Në garat e Olimpiadës së Përbashkët Kosovë-Shqipëri në lëndën e Gjuhës Shqipe 2026, kanë marrë pjesë 102 nxënës të klasës së IX-të nga të gjitha Shkollat Filllore të mesme të ulëta të Komunës së Obiliqit, ku prej tyre 31 nxënës ishin fitues në nivel Komunal, ndërsa në nivel vendi ishin 15 nxënës përfaqësues dhe një nxënës fitues në nivel ndërshtetror
- Në garat e Matematikës kanë marrë pjesë 48 nxënës të SHFMU dhe SHML, ku prej tyre 16 nxënës ishin fitues në nivel Komunal.
- Në garat e Fizikës kanë marrë pjesë 58 nxënës të SHFMU dhe SHML, ku prej tyre 11 nxënës ishin fitues në nivel Komunal

Numri i punëtorëve në Institucionet Edukative Arsimore 2026

Numri i punëtorve të arsimit 2026 është 403 punëtor:

Punëtorët në Instiucionet Edukative Arsimore	Totali
Drejtor	10
Zv.drejtor	2
Mësimdhënës	289
Sekretar	2
Psikolog	3
Logoped	1
Asistent FNV	6
Edukatore	30
Motër edukatore	3
Administrues	6
Biblotekarë	4
P.teknik	47

Numri i punëtorëve ndryshon gati çdo muaj për shkak të pushimeve të lehonisë dhe pushimeve tjera.

Numri i punëtorëve në Institucionet Edukative Arsimore 2026

Instituci onet Arsimor e	Drejt or		Zv.drej tor		Mësimdh ënës		Sekre tar		Psiko log		Logop ed		Asiste ntë FNV		Eduka torë		Motër edukat ore		Adminis trues		Biblote karë		Servis uese/ Kuzhi njere		P.tekn ik		M	F	Tota li
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M					
IP Rrita jonë	1													3		3		5						3				1 5	15
Dr.Ibrahi m Rugova	1			1	64	8	1		2		1		3		1 1						1				1	7	16	8 5	101
Hasan Prishtina		1		1	35	4			1				1		3										2	3	42	9	51
Pandeli Sotiri	1				19	3							1		3										3	2	5	2 7	32
Naim Frashëri	1				15	5									1	1										3	17	9	26
Migjeni	1				10	6									2				1		1					3	9	1 5	24

Abduhrr amon Gërguri		1			10	2								2										1	1	4	1 3	17
Fazli Grajqevc i	1				27	3						1		4										3	6	3 3	39	
17 Shkurti	1				10	8																	1	1	9	1 2	21	
Ismail Dumoshi		1			24	16	1		1										1	1			1	5	23	2 8	51	
IEFH- Milloshe vë																												
IEFH- Mazgit																												
Sveti Sava					7	5																			5	7	12	
Dositej Obradov iq						3																	1	1	4	1	5	

Trajnimet

Trajnimet e Stafit Pedagogjik në Institucionet Edukative Arsimore 2025/2026

Nr.	Trajnimet 2025/2026	SHFMU “ Dr.Ibrahim Rugova”	SHFMU Pandeli Sotiri”	SHFMU “ Hasan Pristina”	SHFMU “ Naim Frashëri”	SHFMU “ Fazli Grajqevci”	SHFMU “ Migjeni”	SHFMU “ Abduhrramon Gërguri”	SHMLP “ Ismail Dumoshi”	Gjimnazi “ 17 Shkurti”	IP “ Rrita jonë”	IEFH - Milloshevë	IEFH - Mazgit
1	Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social	9			1	2		5					
2	Mirëqenia psikologjike e mësimeve dhe vetëkujdesi							8					
3	Gjithëpërfshirja dhe individualizimi i mësimit për nxënës me nevoja të veqanta arsimore (PIA)		2	7	2	3	1	1	1			2	
4	Projekti WemPower për Fëmijërin e Hershme											6	
5	Shprehjet për adoleshencën				1	1			21				

6	Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënje – Word, Excel, PowerPoint	19			3	2			8				
7	Intelegjenca Artificiale dhe përdorimi i saj në mësimdhënje dhe Arsimit në Epokën Digjitale								7				
8	“Ndihmë psikoedukative për nxënësit me sjellje të papërshtatshme”								1				
9	Mentorimi kolegjal në arsim								1				
10	Zhvillimi i shkathtësive të gjelbra								1				
11	Edukimi Medial								1				
12	Teaching ëith impact					1			1				
13	Oda e kodimit dhe intelegjencës Artificiale			3	1	3							
14	Shkathtësit për zhvillim personal				3								

15	MBP – Mësimi i bazuar në projekte				1								
16	PIA për nxënësit me dëmtim dëgjimi			12								1	
17	Diskriminimi në bazë të gjinisë			2									
18	Green Generation	3		5		1							
19	Unity in Care“Unë mbështes miqtë e mi”	2											
21	Lëvizje, Lojë, Sport dhe Kreativitet	3											
22	Lëviz dhe Përfshiju	3											
24	Dialogu Social	2											
25	Music based activities for todays Classroom					1							
26	Help your students excel in ESOL for schools B1-B2					1							

Konkurset dhe rekreutimet gjatë periudhës gjashtëmujore janar- qershor 2026

Nga muaji janar janë shpallur 28 Konkurse, prej tyre 7 konkurse me kohë të pa caktuar dhe 21 konkurse me kohë të caktuar

Nr.	Titulli i vendit të punës	Institucioni Edukativ Arsimor	Vendi	Vend i lirë/ Zëvendësim
1	Edukatë Muzikore	SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Obiliq	Vend i lirë
2	Gjuhë Shqipe	SHFMU “Hasan Prishtina”	Millosevë	Vend i lirë
3	Mësuese Klase	SHFMU “Fazli Grajqevci”	Hade e re	Vend i lirë
4	Bazat e Elektronikës	SHMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	Vend i lirë
5	Teknologji Informatike	SHFMU ”Naim Frashëri”	Breznicë	Vend i lirë
6	Nënëpunës Teknik	SHFMU “Migjeni”	Siboc	Vend i lirë
7	Nënëpunës Teknik	SHFMU “Pandeli Sotiri”	Obiliq i vjetër	Vend i lirë
8	Mësuese Klase	SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Obiliq	Zëvendësim
9	Mësuese Klase	SHFMU “Hasan Prishtina”	Millosevë	Zëvendësim
10	Mësuese Klase	SHFMU “Hasan Prishtina”	Millosevë	Zëvendësim
11	Art Figurativ	SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Obiliq	Zëvendësim
12	Gjuhë Angleze	SHFMU “Hasan Prishtina”	Millosevë	Zëvendësim
13	Gjuhë Shqipe	SHFMU “Hasan Prishtina”	Millosevë	Zëvendësim

14	Mësuese Klase	SHFMU “Migjeni”	Siboc	Zëvendësim
15	Mësuese Klase	SHFMU “Migjeni”	Graboc	Zëvendësim
16	Edukatë Qytetare	SHMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	Zëvendësim
17	Ekonomi	SHMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	Zëvendësim
18	Makineri	SHMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	Zëvendësim
19	Gjuhë Gjermane	SHFMU “Pandeli Sotiri”	Obiliq i vjetër	Zëvendësim
20	Edukatë Fizike	SHFMU “Abduhrramon Gërguri”	Dardhishtë	Zëvendësim
21	Gjuhë Gjermane	SHFMU “Pandeli Sotiri”	Obiliq i vjetër	Zëvendësim / Rishpallur
22	Kimi	SHFMU “Naim Frashëri”	Breznicë	Zëvendësim
23	Edukatore	SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Obiliq	Zëvendësim
24	Gjuhë Gjermane	SHFMU “Pandeli Sotiri”	Obiliq i vjetër	Zëvendësim / Rishpallur
25	Asistent Administrativ	Drejtoria e Arsimit	Obiliq	Me projekt
26	Makineri	SHMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	Zëvendësim / Rishpallur
27	Gjuhë Gjermane	SHFMU “Pandeli Sotiri”	Obiliq i vjetër	Zëvendësim / Rishpallur
28	Edukatë	SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”	Obiliq	Vend i lirë / Rishpallur
29	Asistente FNVA	IEA	Obiliq	Shpallur konkurs për pesë (5) vende

Subvencionet e DKA-së për vitin shkollor dhe akademik 2025-2026

Ndarja e subvencioneve	Numri i konkurruesve	Numri i përfitueseve	Numri i jopërfituesve	Mjetet e ndara	Femra përfituese të subvencioneve	Meshkuj përfituese të subvencioneve
Kompenzimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të SHFMU dhe SHML	993	805	188	81,400.00€	413	392
Kompenzimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës me nevoja të veqanta	51	51	0	25,500.00€	21	30
Bura për nxënësit e SHML me sukses të shkëlqyeshëm	75	59	16	18,550.00€	47	12
Bursa për studentët e nivelit BACHELOR	186	141	45	51,200.00€	115	26

Bursa për studentët e nivelit MASTER	62	45	17	19,700.00€	32	13
Bursa për studentët e nivelit të DOKTORATURËS	4	3	1	3,600.00€	1	2
Gjithsej	1371	1104	267	199,950.00€	629	475

Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit organizon transportin edhe për një numër të nxënsëve, për transportin e nxënësve janë dy minibusa të komunës, të cilët bartin nxënësit nga Babimoci dhe Raskova, në SHFMU “Hasan Prishtina” në Milloshevë. Nga vendbanimi Babimoc barten 16 nxënës, nga Llazareva 11 nxënës dhe nga rruga Obiliqi 9 nxënës.

Planfikimi i projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe planet për vitin 2026/27

INVESTIMET KAPITALE

Projekti	Lokacioni	Përfituesit	Arsyeshmëria	Vlera
Çerdhja e Re	Lajthishtë	Fëmijët e Hades, Grabocit, Shipitullës, Sibocit, Leshkoshiqit dhe Caravodicës	Mungesa e kapaciteteve për edukimin në fëmijërinë e hershme në këtë zonë.	210,000.00€
Çerdhja e Re	Breznicë	Fëmijët e Breznicës dhe Kozaricës	Nevoja për zgjerimin e kapaciteteve parashkollore.	210,000.00€
Çerdhja e Re	Dardhishtë (Kryshec)	Fëmijët e vendbanimit	Mbingarkesa e institucioneve ekzistuese parashkollore.	210,000.00€
Çerdhja e Re	Plemetin	Fëmijët e vendbanimit	Nevoja për krijimin e kapaciteteve të reja parashkollore.	210,000.00€
Salla e Edukatës Fizike	SHFMU “Naim Frashëri”, Breznicë	Mbi 200 nxënës	Mungesa e sallës sportive për realizimin e plan-programit mësimor.	350,000.00€
Objekti i Ri Shkollor	SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova”, Mazgit i Ultë	205 nxënës	Objekti aktual është i pamjaftueshëm për zhvillimin e procesit mësimor.	900,000.00€
Aneksi i Ri	SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova”, Obiliq	929 nxënës	Nevoja për ndarjen funksionale të cikleve 1–5 dhe 6–9.	1,500,000.00€

Salla e Edukatës Fizike	SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova”, Mazgit i Epërmm	150 nxënës	Mungesa e sallës sportive për realizimin e plan-programit mësimor.	350,000.00€
-------------------------	---	------------	--	-------------

RENOVIMET DHE MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS EKZISTUESE

Projekti	Lokacioni	Përfituesit	Gjendja / Nevojat	Vlera
Renovim & Modernizim	SHFMU “Ibrahim Rugova”	989 nxënës	Nevojitet renovimi i rrjetit elektrik, kanalizimit, plafonave dhe sistemit të ndriçimit.	150,000.00€
Renovim & Ristrukturim	SHFMU “Hasan Prishtina”	648 nxënës	Nevojitet rregullimi i oborrit, hyrje-daljeve dhe qarkullimit të automjeteve për rritjen e sigurisë së nxënësve.	150,000.00€
Renovim & Modernizim	IP “Rrita Jonë”	100 fëmijë	Nevojitet ndërrimi i dymve, dritareve, laminatit, sistemit të ngrohjes dhe riinstalimi i rrjetit elektrik.	30,000.00€
Renovim & Modernizim	Objekti shkollor “Migjeni”, Graboc	Nxënësit e shkollës	Objekti ka nevojë për renovim të brendshëm dhe të jashtëm, përmirësim të instalimeve elektrike, sanitare dhe rritje të efikasitetit energjetik.	20,000.00€

Renovim & Modernizim	Objekti shkollor “Fazli Graiçevci”, Hade e Re	Nxënësit e shkollës	Nevojitet renovimi i hapësirave mësimore, nyjeve sanitare, sistemit të ndriçimit dhe përmirësimi i kushteve infrastrukturore.	40,000.00€
Renovim & Modernizim	Objekti shkollor “Dositej Obradović”, Palaj (Vodicë)	Nxënësit e shkollës	Nevojitet renovimi i objektit, përmirësimi i kushteve teknike, instalimeve dhe masave për siguri dhe efikasitet energjetik.	40,000.00€
			TOTAL	4,370,000.00€

Shpenzimet buxhetore për gjashtë muaj në disa kategori

	Arsimi Parafillor	Arsimi Parafillor	Arsimi i mesëm	Arsimi	Drejtoria e Arsimit	Arsimi Fillor	Arsimi Fillor	Arsimi i mesëm	Arsimi i mesëm	Arsimi fillor	Dona fillor
	M.dhe sherbime	Komunalit	Subvecionet	Kapitalet	M.dhe sherbime	M.sherbimet	Komunalit	M.sherbime	Komunalit	subvencionet	Dona .Japoc
Vrejtje											
Buxheti-10	36,500.00	5,187.90	100,000.00		38,500.00	161,445.00	15,000.00	37,685.00	15,000.00	100,000.00	19,800.00
Buxheti 21	7,500.00										
Buxheti-21											
Subvencione										4000.00	

Mbetje 21 s											
Zotime 21											
Mbetje 21											
Zotime	10,149.92	1,521.99	99,950.00		34,341.55	133,117.95	7,590.41	26,281.30	9,960.72	100,000.00	19,8
Mbetje	26,350.08	3,665.91	50.00	0.00	4,158.45	28,327.05	7,409.59	11,403.70	5,039.28	0.00	0.00

1. Investimet emergjente në IEA
2. Furnizimi me materiale higjenike për Institucionet Edukative Arsimore
3. Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në Institucionet Edukative Arsimore
4. Pemë dhe perime për IP “Rrita jonë” në Obiliq
5. Vazhdimi i projekteve me NPL “Kastioti”
6. Dru dhe Pelet për IEA
7. Trajnimi i 20 mësimeve me Fakultetin e Edukimit dhe OJQ “TOKA”
(Marrëveshje mes Komunës së Obiliqit dhe Fakultetit të Edukimit)
8. Vazhdimi i Furnizimi dhe montimi i mbishkrimeve në Institucionet Komunale,
reklama ndriqese për objektet Komunale në Obiliq
9. Furnizimi dhe vendosja e rrjetave sportive dhe rekuizita në IEA
10. Furnizimi me mbulesa në Institucionet e Fëmijërin e Hershme në Milloshevë dhe
Mazgit
11. Furnizimi me Tepiha për klasa dhe koridore në Institucionet e Fëmijërin e
Hershme në Milloshevë dhe Mazgit
12. Shtruarja e dhysheve të klasave të shkollës dhe sallës sportive me epoxit në
SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” në Obiliq (Donator Qeveria Japoneze).
13. Furnizimi me tonera në IEA
14. Furnizimi me leter per kopje

Në programin e intranetit gjatë muajve të parë të këtij viti janë regjistruar 759 kërkesa, kryesisht kërkesa të paleve dhe nga arkivi komunal të cilat janë në process të shqyrtim.

Regjistruar	Miraturar	Refuzuar	Anuluar	Transferuar	Në Proces
759	587	84	7	1	80

Aktivitetet DA 2026

Gjatë periudhës shtator–qershor, Drejtoria e Arsimit ka realizuar një varg aktivitete të rëndësishme që kanë kontribuar në avancimin e proceseve administrative, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, fuqizimin e bashkëpunimit institucional dhe promovimin e arsimit gjithëpërfshirës në institucionet Edukative Arsimore.

Në kuadër të menaxhimit administrativ dhe organizimit të brendshëm, është realizuar regjistrimi i inventarit në të gjitha Institucionet Edukative d Arsimore, duke mundësuar evidentimin dhe menaxhimin më efikas të pasurisë shkollore. Po ashtu, Drejtoria e Arsimit ka ndërmarrë hapa konkretë në procesin e digjitalizimit të shërbimeve, përmes projektimit dhe krijimit të një aplikacioni për menaxhimin e kontratave, faturave dhe financave, i cili ka lehtësuar ndjeshëm proceset administrative dhe financiare.

Në fushën e teknologjisë informative dhe komunikimit, është realizuar kyçja dhe instalimi i rrjetit në SHFMU “Pandeli Sotiri” në Obiliq i vjetër, si dhe instalimi i internetit në SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” në Mazgit të ulët, duke përmirësuar kushtet për zhvillimin e procesit mësimor dhe qasjen në teknologji bashkëkohore.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me organizata dhe institucione të ndryshme që veprojnë në fushën e arsimit. Janë zhvilluar takime pune ndërmjet zyrtarëve të Drejtorisë së Arsimit dhe KEC-it për organizimin dhe realizimin e trajnimeve profesionale. Gjithashtu, janë mbajtur takime me ekipin e FNV për vlerësimin dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe takime të përbashkëta me Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë, organizatën Gjithëpërfshirja, të udhëhequr nga z. Arben Zabeli, organizatën Concordia dhe përfaqësuesit e Terre des Hommes, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe forcimit të bashkëpunimit në mbështetje të nxënësve.

Në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës, janë organizuar takime të rëndësishme ndërmjet Qendrës Burimore “Përparimi” në Prishtinë dhe Qendrës Burimore “Nënë Tereza” në Prizren, me fokus shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta. Po ashtu, janë zhvilluar takime me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta lidhur me shndërrimin e klasës bashkangjitur në SHFMU

“Dr.Ibrahim Rugova” në dhomë burimore, me synim krijimin e kushteve më të mira për përfshirjen e nxënësve në klasat e rregullta dhe rritjen e cilësisë së mbështetjes pedagogjike.

Gjatë kësaj periudhe është siguruar edhe një donacion i vlefshëm nga Shtypshkronja “Berati”, përmes të cilit shkollat SHFMU dhe SHML janë furnizuar me lektura dhe romane për pasurimin e bibliotekave shkollore dhe nxitjen e kulturës së leximit tek nxënësit.

Për më tepër, Drejtoria e Arsimit ka organizuar takime pune me psikologët e shkollave për planifikimin dhe realizimin e sesioneve vetëdijësuese për nxënësit e SHFMU-ve dhe SHML-ve, me qëllim promovimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe edukative të tyre.

Drejtoria e Arsimit ka realizuar programin festiv për nder të 17 Shkurtit- Dita e Pavarësisë Kosovës, në këtë program festiv morrën pjesë të gjithë nxënësit e SHFMU dhe SHML të Komunës së Obiliqit.

Me rastin e **17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës**, në bashkëpunim me institucionet arsimore të komunës, është organizuar program festiv me pjesëmarrjen e nxënësve nga shkollat fillore dhe të mesme.

Aktiviteti është mbajtur në **Sallën e Sportit “Adem Jashari”**, ku nxënësit kanë prezantuar programe kulturore dhe artistike përmes recitimeve, këngëve dhe performancave të ndryshme tematike, duke shënuar në mënyrë dinjitoze këtë datë të rëndësishme për vendin.

Me këtë rast, u ndanë mirënjohje për nxënësit që kanë arritur suksese në Olimpiadën e Fizikës në nivel vendi, si dhe për mësimdhënëset e tyre për kontributin profesional dhe përkushtimin e vazhdueshëm në përgatitjen e nxënësve.

Mirënjohjet iu ndanë nxënësve:

Alketa Thaçi dhe Amar Behrami.

Si dhe mësimdhënëseve:

Majlinda Gashi dhe Fatbardha Klinaku Dedinca.

Në bashkëpunim me Drejtoria e Kulturës, u organizuan gara në futsal me pjesëmarrjen e ekipeve shkollore nga zona. Ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e sportit, bashkëpunimit dhe frymës garuese ndërmjet nxënësve.

Në kuadër të aktiviteteve u organizua event i ndërgjegjësues “Unë i them JO dhunës”, i cili u mbajt në ambientet e Biblioteka e Qytetit. Qëllimi i eventit ishte rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit lidhur me fenomenin e dhunës në familje dhe promovimi i një shoqërie më të sigurt

Gjithashtu u mbajt tryeza e diskutimit me temë “Ngritja e Kapaciteteve Arsimore: Praktika dhe Mbështetje Profesionale për Barazi në Arsimin e të Talentuarve”, e organizuar nga BPrAL – Kolegji Heimerer. Qëllimi i kësaj tryeze ishte avancimi i praktikave arsimore dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të akterëve të përfshirë në sistemin arsimor, me fokus të veçantë në krijimin e mundësive të barabarta për nxënësit e talentuar

Takim me Qendren Burimore Perparimi Prishtinë me qëllim të ofrimit të mbështetjes profesionale për avancimin e një arsimit sa më cilësor dhe gjithëpërfshirës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Si dhe me Organizatën Dëgjo Zërin tim”.

Për nder të 7 Marsit – Ditën e Mësuesit, Drejtoria e Arsimit në Kuvendin Komunal të Komunës së Obiliqit ndau mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar në nivel Komune për vitin shkollor 2025/2026.

Gjatë këtij organizimi, u ndanë mirënjohje për një numër mësimdhënësish të dalluar, të cilët janë veçuar për angazhimin e tyre në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe edukimit të nxënësve. Përzgjedhja e tyre u bazua në kriteret e performancës, inovacionit në mësimdhënie dhe ndikimit pozitiv në komunitetin shkollor. Shkolla me e paster

Gjithashtu, mirënjohje e veçantë iu dha edhe Shkolla “Naim Frashëri” e cila u vlerësua si një ndër shkollat më të suksesshme, me arritje të larta në procesin edukativo-arsimor dhe me një angazhim të vazhdueshëm në aktivitete zhvillimore.

Organizata Gjermane “Familien in Not e.V.” Rietberg në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit ka shpërndarë dhurata për nxënësit në SHFMU “Migjeni” në Siboc dhe Fëmijët me nevoja të veçanta të Komunës së Obiliqit

Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me Flutura Ibrahim, drejtoreshë ekzekutive e fondacionit UTALAYA kanë organizuar aktivitetin e projektiti “Uta në Sharr”. Në këtë aktivitet morën pjesë nxënësit nga mosha 9-12 vjeq, nga 4 SHFMU të komunës së Obiliqit.

Drejtorja e Arsimit për garën e Olimpiadës së Përbashkët Kosovë – Shqipëri, në lëndën e Gjuhës shqipe për klasën e nënta (9) 2026 në nivel Komunal u ndau mirënjohje, për nxënësit fitues sipas vendeve fituese.

Të gjitha këto aktivitete dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të Drejtorisë së Arsimit për modernizimin e sistemit arsimor, përmirësimin e kushteve të punës dhe mësimin, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe garantimin e një arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit.

Organizata joqeveritare “Dëgjo Zërin Tim” në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, organizoi aktivitetin me nxënësit e shkollave të Komunës sonë për nderë të 1 Qershorit – Dita e Fëmijëve.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport për realizimin e aktivitetit Karvanet e fëmijëve më 16-18 Qershor 2026 në Obiliq, morën pjesë nxënësit e SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq.

Marrëveshje Bashkëpunimi

Gjatë periudhës gjashtëmujore, Drejtoria e Arsimit ka vazhduar të zhvillojë dhe të forcojë bashkëpunimin me organizata dhe projekte të ndryshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë në arsim dhe avancimin e praktikave edukativo-arsimore.

Në këtë drejtim, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën “Teach for Kosovo”, me projektin “WEMPOWER”, si dhe me organizatën “SHPIK”, me synim mbështetjen e institucioneve arsimore, zhvillimin profesional të mësimeve dhe fuqizimin e nxënësve në procesin mësimor.

Këto bashkëpunime janë orientuar në implementimin e projekteve që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe në krijimin e mundësive të reja për zhvillim profesional dhe institucional.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka realizuar aktivitetet e parapara në Planin Vjetor të Punës, me fokus në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, avancimin e infrastrukturës shëndetësore, fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe mbështetjen e kategorive në nevojë.

Aktivitetet janë zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, institucionet lokale dhe qendrore, organizatat partnere dhe donatorët, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Obiliqit.

SHËNDETËSIA

Në sektorin e shëndetësisë, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar suksesshëm të gjitha aktivitetet e planifikuara, të ndara në pesë fusha prioritare. Në kuadër të infrastrukturës dhe pajisjeve shëndetësore, ngjarja kryesore kapitale ishte vendosja e gurthemelit dhe fillimi i punimeve për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Paralelisht, janë kryer renovime dhe mirëmbajtje në objektet ekzistuese, institucionet janë furnizuar me aparaturë mjekësore, janë siguruar furnizimet me oksigjen mjekësor, si dhe janë në fazë përgatitore kontratat për servisimin e rregullt të pajisjeve.

Sa u përket shërbimeve shëndetësore, është garantuar ofrimi i vazhdueshëm i kujdesit parësor dhe referimi i rregullt i pacientëve në nivelet sekondare dhe terciare. Gjithashtu, është siguruar furnizimi i qëndrueshëm me barna nga Lista Esenciale dhe material shpenzues, si dhe kanë vazhduar pa ndërprerje shërbimet e kujdesit paliativ shtëpiak për pacientët në nevojë.

Në fushën e parandalimit, imunizimit dhe promovimit të shëndetit, është zbatuar programi i rregullt i vaksinimit të fëmijëve sipas kalendarit kombëtar. Janë realizuar fushata vetëdijesuese dhe ligjërata edukative mbi planifikimin familjar, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si dhe parandalimin e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe substancave narkotike.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar shëndetit të fëmijëve dhe nxënësve përmes vizitave sistematike dhe kontrolleve parandaluar nëpër shkolla për zbulimin e hershëm të anomalive. Janë zhvilluar aktivitete për shëndetin oral dhe fluoridimin e dhëmbëve, vizita patronazhi për nënat dhe fëmijët e moshës 0–3 vjeç, si dhe ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me UNICEF-in. Për fund, sa i përket zhvillimit profesional, është investuar në

ngritjen e kapaciteteve të stafit shëndetësor përmes trajnimeve të vazhdueshme në fushat prioritare të kujdesit mjekësor.

MIRËQENIA SOCIALE

Në kuadër të Mirëqenies Sociale dhe Menaxhimit Institucional, puna gjatë këtij gjashtëmujori është shtrirë në katër shtylla kryesore. Një arritje e veçantë dhe shumë domethënëse gjatë kësaj periudhe është nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). Ky bashkëpunim dyvjeçar, i lidhur përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS), ka për qëllim ofrimin e mbështetjes së specializuar psikologjike dhe ligjore, si dhe referimin e duhur për të miturit dhe fëmijët nën moshën 14-vjeçare që janë viktimë të dhunës seksuale. Përmes kësaj marrëveshjeje, synohet edhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të QPS-së me qasje të informuara për traumën, si dhe ndërgjegjësimi i akterëve të sistemit të drejtësisë e sigurisë.

Krahas këtij partneriteti strategjik, sa i përket përkrahjes sociale të rregullt, janë menaxhuar subvencionet për personat me sëmundje kronike e malinje, është ofruar mbështetje financiare për nënat lehona, familjet strehuese dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me institucionet përgjegjëse për familjet në asistencë sociale. Në fushën e shërbimeve sociale, fokus i veçantë i është kushtuar ofrimit të shërbimeve psikologjike për qytetarët në nevojë, mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore, si dhe bashkëpunimit me organizatat joqeveritare për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve. Njëkohësisht, përkujdesja për të moshuarit është jetësuar përmes aktiviteteve mirëmbajtëse në Shtëpinë e Pensionistëve dhe zhvillimit të shërbimeve të kujdesit direkt në shtëpi për personat e moshuar dhe kategoritë e cenuara.

SHËNDETËSIA

Në nivel institucional, gjatë periudhës Janar–Qershor 2026 janë trajtuar gjithsej 53,785 pacientë dhe janë ofruar 155,228 shërbime mjekësore, me një mesatare të përgjithshme prej 423.5 pacientësh në ditë.

- QKMF Obiliq: Ka përballuar pjesën kryesore të ngarkesës me 46,166 pacientë dhe 124,422 shërbime (mesatarisht 363.5 pacientë/ditë).
- QMF Milloshevë: Ka trajtuar 3,658 pacientë dhe ka ofruar 16,509 shërbime (28.8 pacientë/ditë).
- AMF Babimoc : Ka regjistruar 1,298 pacientë dhe 4,385 shërbime (10.2 pacientë/ditë).
- AMF Siboc: Ka trajtuar 1,104 pacientë me 4,434 shërbime (8.6 pacientë/ditë).
- AMF Breznicë: Ka pasur 1,029 pacientë dhe 2,207 shërbime (8.1 pacientë/ditë).

- AMF Plemetin: Ka pasur 530 pacientë dhe 3,271 shërbime (4.17 pacientë/ditë).

Sistemi i Referimeve dhe Kujdesit dytësor/tretësor

Nga një total prej 41,274 vizitash mjekësore të analizuar në platformat e raportimit, janë lëshuar 6,500 udhëzime drejt nivelit sekondar dhe terciar, që përfaqëson një shkallë referimi prej 15.7%.

- Sipas Kategorive të Referimit: 4,125 referime janë lëshuar për konsultime, 682 për diagnostikë dhe 1,693 drejt Qendrës Emergjente.
- Sipas Njësive: Shkallën më të lartë të referimeve e ka pasur AMF Babimoc me 32% (417 udhëzime nga 1,298 vizita) dhe QMF Milloshevë me 20.3%. Mjekësia Familjare në QKMF ka referuar 16.8% të rasteve (3,134 udhëzime nga 18,584 vizita), ndërsa Shërbimi i Urgjencës ka referuar 14.7% (1,714 udhëzime nga 11,634 vizita, ku 1,443 ishin për Qendrën Emergjente). Shkallën më të ulët e ka shënuar AMF Plemetin me vetëm 2.2% referime.

Sektori i Kujdesit Urgjent

Urgjenca ka pasur një volum mjaft të lartë me 11,634 pacientë të vizituar dhe 16,085 shërbime të ofruara. Ka trajtuar 1,812 raste urgjente akute dhe ka realizuar 992 vizita shtëpiake emergjente me mjek dhe infermier. Janë kryer 928 EKG, 3,157 infuzione, 1,592 dhënie të kortikosteroideve, 213 inhalime dhe 2 raste të përdorimit të AED-së (Defibrilatorit).

Sektori i Kujdesit Paliativ

Ky sektor ka realizuar 1,809 vizita shtëpiake për pacientët kronikë dhe ata në fazat terminale, me gjithsej 1,088 pacientë të trajtuar dhe 4,137 shërbime. Janë administruar 774 infuzione, 292 antibiotikë dhe janë kryer 23 verifikime të rasteve të vdekjes në shtëpi.

Pediatria dhe Gjinekologjia (QKMF)

- Pediatria: Ka regjistruar 1,638 pacientë dhe 3,880 shërbime. Janë kryer 861 matje të peshës/gjatësisë dhe 434 matje temperature. *(Shënim: Për shkak të pengesave në sistemin BHIS, që nga data 21.05.2025 pacientët e Pediatrisë regjistrohen në sistem nën Mjekësinë Familjare për të mos penguar raportimin e sëmundjeve ngjitëse).*
- Gjinekologjia: Ka regjistruar 788 pacientë dhe 2,284 shërbime. Janë kryer 539 vizita gjinekologjike + ECHO, 198 vizita obstetrike (shtatzëna), 86 PAP-teste, 51 CTG dhe janë shpërndarë 320 kondomë. Në "Klasat për Nëna" kanë marrë pjesë 215 gra.

Shëndeti Publik dhe Imunizimi

Në njësinë e vaksinimit janë ofruar 7,914 shërbime totale, duke administruar 3,276 vaksina për 1,357 pacientë në qendër dhe në terren. Janë regjistruar gjithashtu 48 nëna gjidhënese.

Shëndeti Oral (Stomatologjia)

Janë trajtuar 827 pacientë me 4,439 shërbime. Janë realizuar 147 heliopllomba, 71 ekstraksione të dhëmbëve të qumështit dhe 38 të dhëmbëve të përhershëm. *(Shënim administrativ: Shërbimi i Stomatologjisë është zhvendosur përkohësisht në QMF Milloshevë deri në përfundimin e objektit të ri, andaj të dhënat pasqyrohen në një raport të vetëm).*

Sektori i Diagnostikës (Laboratori dhe Radiologjia)

- Laboratori Qendror (QKMF): Ka trajtuar 2,890 pacientë me një total prej 42,007 parametrash të punuar. Ndër analizat më të shpeshta: 2,405 hemograme, 1,693 analiza urine, 1,542 CRP, 1,494 SE, 1,418 urea/kreatininë dhe 1,328 glikemi.
- Laboratori QMF Milloshevë: Ka pasur 904 pacientë me 13,843 parametra të punuar (përfshirë 737 hemograme dhe 555 analiza urine).
- Rentgeni (RTG) dhe Ultrasonografia (ECHO): RTG ka kryer 2,477 ekzaminime për 1,292 pacientë (1,128 skelet dhe 307 trakt respirator). Shërbimi i ECHO-s ka kryer 1,488 shërbime për 627 pacientë, ku dominojnë 408 ECHO të abdomenit dhe 147 ECHO të gjirit. Janë kryer gjithashtu 220 shërbime të Mamografisë për 55 paciente.
- Qarkullimi i Barnatoreve: Në të gjitha pikat e shërbimit janë trajtuar 3,474 pacientë (699 fëmijë dhe 2,775 të rritur) dhe janë lëshuar 7,573 receta.

Programi i Vizitave në shtëpi për fëmijët 0–3 vjeç dhe gratë shtatzëna

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, në kuadër të Programit të Vizitave në Shtëpi në Komunën e Obiliqit, janë realizuar gjithsej 262 vizita në shtëpi, prej të cilave 236 vizita për fëmijët e moshës 0–3 vjeç dhe 26 vizita për gratë shtatzëna.

Në këtë periudhë janë realizuar 108 vizita të para për fëmijët e moshës 0–3 vjeç, përkatësisht 56 vajza dhe 52 djem. Gjithashtu janë kryer 60 vizita të dyta, 30 vizita të treta, 10 vizita të katërta dhe 9 vizita të pesta, duke dëshmuar vazhdimësinë e ndjekjes së fëmijëve sipas standardeve të programit.

Sa i përket kujdesit për gratë shtatzëna, janë realizuar 26 vizita të para.

Nga fëmijët e vizituar, 45 fëmijë kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda tri ditëve pas lindjes, ndërsa 46 baballarë janë përfshirë dhe kanë qenë të pranishëm gjatë realizimit të vizitave në shtëpi.

Në kuadër të programit, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe komuniteteve jo-shumicë. Janë realizuar 29 vizita të para për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe 7 vizita për gratë shtatzëna nga këto komunitete.

Gjatë periudhës raportuese nuk është referuar asnjë fëmijë tek specialistët nga ekipi i mjekësisë familjare. Gjithashtu janë realizuar 9 vizita shtesë, jashtë standardit të programit, bazuar në nevojat e identifikuara në terren.

Nga aktivitetet në terren janë identifikuar dhe referuar 1 rast social, ndërsa nuk është identifikuar asnjë rast i dhunës gjatë vizitave në shtëpi. Po ashtu, është evidentuar 1 fëmijë me ngecje në zhvillim, i cili është referuar për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm.

Edukimi Shëndetësor dhe Trajnimet (ZHVP)

Në kuadër të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional, në sallën e trajnimeve të QKMF-së janë mbajtur 12 ligjërata të brendshme për mjekë dhe infermierë. Gjithashtu, infermieret e mamografisë kanë kryer trajnime teknike 10-ditore në QKUK.

Në komunitet u shënuar "Java Botërore e Imunizimit" (ku u vaksinuan fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Plemetin dhe u mbajt ligjëratë me 41 nxënës), si dhe u zhvilluan aktivitete në sheshin e qytetit për Ditën e Tuberkulozit dhe Muajin e Alzheimerit.

Projektet e inicuar permes zyres se prokurimit:

Titulli i projektit :	Vlera e zotimit te mjeteve:
• 1. Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim:	29,989.72 €
• 2. Furnizim me mjete higjienike:	9,998.00 €
• 3. Furnizim me oksigjen:	3,820.00 €
• 4. Furnizim me material administrativ:	3,000.00 €
• 5. Asgjësimi i barnave:	2,659.00 €
1. Investime Kapitale (Total: 384,449.70 €)	
• Ndërtimi i QKMF-së në qytetin e Obiliqit: 384,449.70 €	

Mallra dhe Shërbime (Total: 91,562.12 €)

Kjo kategori përfshin shpenzimet operative shëndetësore dhe administrative. Shpenzimet kryesore janë:

- Furnizim me material laboratorik: 16,080.00 €
- Mirembajtja e hapësirave publike -NPL “Kastrioti”: 10,934.60 €
- Furnizim me mjete higjienike: : 9,998.00 €
- Karburante: 8,299.82 €
- Furnizim me material administrativ: 3.000 €
- Furnizim me material ampullar: 2,306.00 €
- Material radiologjik-stomatologjik: 1,190.00 €
- Furnizime mjekësore: 988.00 €
- Furnizim me material stomatologjik: 798.00 €
- Shërbimet e trajnimit për personel shëndetësor: 800.00 €
- Petty Cash (Para të gatshme): 500.00 €
- Regjistrimi i automjeteve: 105.00 €
- Mirëmbajtja e dozimetrave: 60.00 €
- Internet: 33.98 €

3. Komunali (Total: 15,081.93 €)

Shpenzimet për shërbime publike (komunale) ndahen si vijon:

- Rrymë: 13,598.72 €
- Ujë: 1,236.20 €
- Telefon: 247.01 €

4. Subvencione (Total: 101,150.00 €)

- Subvencione (për 249 përfitues): 75,800.00 €
- Lehona (për 164 përfituese): 25,350.00

Gjatë kësaj periudhe, Shërbimet Sociale dhe Familjare kanë trajtuar një numër të madh rastesh të ndara sipas kategorive specifike, si dhe kanë lëshuar vërtetime administrative.

1. Mbrojtja e Fëmijëve dhe Trajtimi i të Miturve

- Fëmijë pa kujdes prindëror: 11 raste.
- Strehimi: 8 fëmijë në strehim familjar (te të afërmit), 2 në familje strehuese dhe 1 në strehim rezidencial.
- Adoptimet: 5 kërkesa në total (3 vendore dhe 2 ndërkombëtare).
- Të miturit në konflikt/problem me ligjin: 19 të mitur në konflikt me ligjin dhe 12 fëmijë me papërgjegjësi penale.
- Raste të tjera sensitivë: 8 fëmijë të keqtrajtuar dhe 6 martesë të të miturve.

2. Dhuna në Familje dhe Çështjet Martesore

- Dhuna në familje: 38 viktimë të trajtuara.
- Krimet seksuale: 1 viktimë.
- Këshilla martesore (Divorc): 17 raste.

3. Përkrahja për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Kategoritë e Tjera

- Fëmijë me aftësi të kufizuara: 86 raste
- Personat me aftësi të kufizuar / pa zotësi veprimi: 4 raste.
- Prindërit vetushqyes: 20 raste.
- Probleme familjare të përgjithshme: 38 klientë.
- Të moshuar: 2 raste.
- Prindërim joadekuat: 2 raste ku prindërit nuk ishin adekuatë për përkujdesje.

4. Shërbimet Administrative (Lëshimi i Vërtetimeve)

Në total janë lëshuar 183 vërtetime dhe dokumente, të ndara si vijon:

- Për punësim: 102
- Për shtetësi (fitim/humbje): 29
- Për Skemën e Ndihmës Sociale (SNS): 24
- Për armëmbajtje: 21

- Për letërnjoftim / pasaportë: 6
- Regjistrim i mëvonshëm i fëmijëve: 1

Të dhënat e përgjithshme për familjet dhe anëtarët në SNS

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, numri i familjeve, anëtarëve përfitues dhe shumat financiare të shpërndara sipas muajve paraqiten si më poshtë:

- Janar: Skema ka përfshirë 483 familje me gjithsej 1,967 anëtarë, ndërsa shuma e shpërndarë ka qenë 76,176.00 €.
- Shkurt: Janë regjistruar 483 familje me 1,977 anëtarë, me një vlerë totale prej 76,248.00 €.
- Mars: Numri i familjeve ka arritur në 485 me 1,981 anëtarë, ku shuma e alokuar ka qenë 76,356.00 €.
- Prill: Janë shënuar 489 familje me 1,998 anëtarë, me një vlerë financiare prej 76,704.00 €.
- Maj: Numri i familjeve ka zbritur në 480 me 1,963 anëtarë, duke kapur shumën prej 75,696.00 €.
- Qershor: Skema ka pasur 472 familje me 1,929 anëtarë, me një vlerë totale prej 74,472.00 €.

Mjetet financiare gjithsej: Për këtë gjashtëmuajor, vlera totale e shpërndarë për Skemën e Ndhmës Sociale ka arritur shumën prej 455,652.00 €.

Dinamika e lëndëve (Aplikimet, Riaplikimet, Riaktivizimet dhe Ndërprerjet)

Gjatë këtij 6-mujori, lëvizjet e rasteve brenda skemës sipas muajve kanë qenë:

- Janar: 3 aplikime, 52 riaplikime, 5 riaktivizime dhe 7 ndërprerje.
- Shkurt: 3 aplikime, 54 riaplikime, 3 riaktivizime dhe 2 ndërprerje.
- Mars: 3 aplikime, 64 riaplikime, 4 riaktivizime dhe 7 ndërprerje.
- Prill: 2 aplikime, 60 riaplikime, 2 riaktivizime dhe 6 ndërprerje.
- Maj: 2 aplikime, 61 riaplikime, 2 riaktivizime i 6 ndërprerje.
- Qershor: 2 aplikime, 58 riaplikime, 2 riaktivizime dhe 12 ndërprerje.

Pasqyra e punës së Komisionit Mjekësor

Lëndët e shqyrtuara bazuar në gjendjen shëndetësore për periudhën Janar - Qershor 2026 janë menaxhuar si më poshtë:

- Janar: Nga 25 lëndë gjithsej, 22 janë aprovuar dhe 3 janë refuzuar.
- Shkurt: Nga 29 lëndë gjithsej, 27 janë aprovuar dhe 2 janë refuzuar.
- Mars: Janë trajtuar 21 lëndë, ku të 21-at janë aprovuar (0 të refuzuara).
- Prill: Nga 31 lëndë gjithsej, 25 janë aprovuar dhe 6 janë refuzuar.
- Maj: Nga 19 lëndë gjithsej, 14 janë aprovuar dhe 5 janë refuzuar.
- Qershor: Gjatë këtij muaji janë trajtuar gjithsej 29 lëndë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, zyra ka lëshuar gjithashtu edhe 12 Vërtetime të SNS-së.

Aktivitetet humanitare dhe donacionet

Përveç mbështetjes institucionale, përmes bashkëpunimit me shoqata dhe donatorë të ndryshëm, është realizuar shpërndarja e ndihmave për familjet në nevojë:

- 16 Shkurt 2026: Organizata nga Emiratet e Bashkuara Arabe ka shpërndarë 75 pako ushqimore dhe nga 10 kg miell për 75 familje me gjendje ekstreme ekonomike në skemën sociale.
- 18 Shkurt 2026: Nga e njëjta organizatë (Emiratet e Bashkuara Arabe) janë shpërndarë kupona për veshmbathje në vlerë prej 100 € për 50 familje të rasteve sociale.
- 27 Shkurt 2026: Fondacioni “Freskia” ka shpërndarë 100 pako ushqimore për 100 familje të rasteve sociale.
- 3 Mars 2026: Shoqata “Qatar Charity” ka shpërndarë 150 pako ushqimore për 150 familje me raste të rënda sociale.
- 3 Mars 2026: Janë pranuar dy donatorë privatë me një vlerë totale prej 200 €, duke ndihmuar katër familje të rasteve sociale.
- 28 Maj 2026: Dy donatorë kanë kontribuar me një vlerë prej 200 € në total, duke mundësuar ndihma me pako ushqimore për katër familje (nga 50 € për familje).
- 29 Maj 2026 (Për Festën e Kurban Bajramit):
 - Shoqata “Shqiptarët për Shqiptarët” ka shpërndarë nga 5 kg mish lope për 400 familje të rasteve të rënda sociale.
 - Shoqata “Amaneti” ka shpërndarë 130 pako ushqimore dhe nga 5 kg mish për 130 familje të tjera me raste të rënda sociale.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjenca

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjenca promovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të shërbimeve publike dhe kryen koordinimin e aktiviteteve të tjera ditore, javore dhe mujore.

Aktivitetet kryesore të planifikuara për vitin 2026 janë si më poshtë:

- Menaxhimi i situatave emergjente.
- Mirëmbajtja e dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit të dimrit.
- Përgatitja e stafit dhe dokumenteve bazë për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe rreziqe tjera.
- Mirëmbajtja dhe deblokimi i kanalizimeve.
- Mirëmbajtja e ndriçimit Publik.
- Vendorsja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal.
- Ofrimi i shërbimeve të recepsionit të objektit të Kuvendit Komunal.
- Ndërtimi i hapësirave për komunitet
- Digjitalizimi i rrugëve dhe objekteve publike në Komunën e Obiliqit
- Transporti publik lokal.
- Suvencionimi për përmirësimin e kushteve të banimit

Kërkesa të Trajtuara nga DSHPE

Gjatë periudhës raportuese janë pranuar gjithësej 585 kërkesa nga qytetaret, operatorët ekonomik, KEDS, KRU Prishtina dhe palë tjera. Nga këto:

- janë shqyrtuar 519 kërkesa
- Janë miratuar 441 kërkesa,
- Janë refuzuara 75 kërkesa
- Në proces 66 kërkesa.
- Janë lëshuar 10 Pëlqime- të natyrave të ndryshme

Kontratat e menaxhuara (nga vitet e kaluara deri në qershor 2026)

1. Shërbime recepsoni (Kontrata në Shtëpi)
2. Sigurimi i veturave Zyrtare
Sa i përket aktivitetit në terren, ai ka qenë i kufizuar për shkak të mosfunksionimit të rregullt të sistemit të tatimit në pronë,. Problemet dhe vështërsitë në sistemin e tatimit vazhdojnë ende edhe pse pjesërisht është i rregulluar mirpo shumë procedura tatimore nuk mund të kryhen përdërisa të kompletohet funksionimi i sistemit të tatimit .

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej 1075 inspektime nga zyrtarët e terrenit në territorin e Komunës së Obiliqit, prej të cilave 207 kanë qenë regjistrime të reja dhe 868 verifikime.



<i>Qershor</i>	659	29	688
<i>Totali</i>	868	207	1,075

Po ashtu, lëshimi i faturave dhe vërtetimeve tatimore ka qenë i reduktuar për shkak të të njëjtave arsye.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar 32 kërkesa/ankesa prej tyre: 28 kërkesa për ndërrim pronësie, 1 kërkesë për ndryshim mbiemrit, 1 kërkesë për kategorizim të parcelës, 1 kërkesë për korigjim faturës dhe 1 ankesë për faturën tatimore, të cilat do të shqyrtohen brenda afateve ligjore.

Megjithatë, vlen të theksohet se mungon zyrtari për ankesa, i cili do të ishte përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave dhe kërkesave të paraqitura, si dhe për dhënien e rekomandimeve për aprovimin apo refuzimin e tyre gjatë gjithë vitit tatimor.

Angazhimi kryesor gjatë kësaj periudhe ka qenë përgatitja dhe lëshimi i 143 njoftimeve përfundimtare për mospagesën e borxheve tatimore, të përgatitura nga zyrtari i inkasimit.

Nga këto njoftime janë realizuar të hyra në vlerë prej 77,411.15 €.

Nga 143 njoftime përfundimtare, 21 tatimpagues kanë përmbushur plotësisht obligimet e tyre pas pranimit të njoftimit, ndërsa 26 të tjerë i kanë përmbushur pjesërisht obligimet, dhe pjesa tjetër mbetet për t'u realizuar në muajt në vijim, sipas afateve ligjore.

Njoftimet janë shpërndarë gjatë muajve Janar dhe Prill nga zyrtarët e terrenit të zyrës së tatimit.

Faturat tatimore për vitin 2026 në sistemin e tatimit në pronë janë lëshuar më 31.03.2026.

Sipas raporteve të zyrtares së tatimit, janë lëshuar gjithsej 94 vërtetime të kërkuara nga tatimpaguesit.


Zyra e Tatimit ka ofruar vazhdimisht informacione dhe sqarime për tatimpaguesit që janë paraqitur fizikisht në zyrë.

Rritja e inkasimit të të hyrave mbetet prioritet i Zyrës së Tatimit, ndërsa nga pagesa e obligimeve tatimore për periudhën Janar–Qershor janë inkasuar gjithsej 227.706.54 €.

<i>Të hyrat Janar - Qershor 2026</i>	
Janar	6,133.21 €
Shkurt	28,801.48 €

Mars	19,757.88 €
Prill	44,999.77 €
Maj	32,888.99 €
Qershor	95,125.21 €
Totali	227,706.54 €

Paraqitja grafike e te hyrave per periudhen Janar – Qershor për vitin 2026



Drejtoria e Infrastrukturës Lokale

1. HYRJE DHE PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale (DIL), gjatë periudhës janar–qershor 2026, ka qenë e angazhuar me kapacitet të plotë në hartimin e paramasave dhe parallogarive, projektimin e projekteve infrastrukturore, mbikëqyrjen teknike të punimeve në realizim, si dhe në shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave të qytetarëve dhe të drejtorive të tjera komunale.

2. PROJEKTET NË FAZËN E REALIZIMIT (EKZEKUTIMIT)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur projektet kapitale ku punimet kanë filluar sipas planit dinamik dhe janë në realizim e sipër në terren.

Emërtimi i Projektit / Përshkrimi i Punimeve	Vlera e Kontratës (€)	Statusi i Projektit
Projekti I “QKMF-së faza e parë”	369,934.31 €	Filluar sipas planit dinamik
Projekti “Rikonstruimi i Trotuarit dhe Shtegut për biçikleta rruga Hasan Prishtina” (Kontrata bazë: 415,008.85 € + Aneks Kontrata: 41,140.00 €)	456,148.85 €	I realizuar
Projekti “Faza II-Vazhdimi i shtrirjes së rrjetës së ngrohjes qendrore”	6,898,358.91 €	Në realizim e sipër
Projekti “Sistemi i Koogjenerimit në Komunën e Obiliqit” Mbikqyrja.	345,000.00 €	Në realizim e sipër
Projekti “Asfaltimi i rrugëve dhe kanalizimit në Babimoc”	216,976.29 €	Në realizim e sipër
Projekti i Pishines Gjysëm Olimpikë	2,859,586.97 €.	Në Proces
Projekti i Salles së Ed Fizike ,në shkollën Ibrahim Rugova	17,377.00€.	I realizuar
Projekti “Renovimi i sallës së Kuvendit”	33,781.00 €	Filluar sipas planit dinamik

“Rikonstruimi i rruges Obiliq -Mazgit”	MAPL- 251,119.98€ Komuna – 147,810.73€	I realizuar
Vlera TOTALE	11,596,094.04	

PROJEKTET E PËRGATITURA NGA DIL-i

Spektori i projektimit pranë DIL-it ka finalizuar projektet teknike, paramasat dhe parallogaritë për projektet e mëposhtme. Një pjesë e madhe e tyre u janë dorëzuar drejtorive përkatëse (linjë) për procedim të mëtutjeshëm të tenderimit:

3.1. Projekte për Infrastrukturën Komunale (Menaxhohen direkt nga DIL):

- Projekti “Kanalizimi në Obiliq”:
- Është në përgatitje paramasa dhe parallogaria me vlerë prej 150,000.00 €.
- Ndërtimi i Kanalizimit në Plemetin .Vlera 30,000.00 €
- Projekti “Rrugët në fshatin Bakshi”: Është përgatitur projekti i plotë me vlerë prej 105,917.85 €.
- Projekti “Rrugët në fshatrat Milloshevë dhe Llazarevë”: Është përgatitur projekti me vlerë prej 100,032.33 €.
- Projekti “Renovimi dhe Rikonstruimi i kulmit të objekteve banesore”: Vlera e parashikuar e projektit kap shifrën prej 266,439.95 €.
- Projekti “Rrugët në fshatin Lajthishtë”
- Projekti “Rrugët në fshatin Mazgit”: Është përgatitur projekti i plotë me vlerë prej 200,550.00
- Projekti “Rruga “Ali Maloku në Dardhishtë” është duke u përgaditur projekti.

3.2. Projekte të përgatitura dhe të dorëzuara në Drejtoritë e tjera:

Drejtoria e Ambientit:

- Projekti “Kanaleta e hapur afër rrugës Mbretëresha Teutë” (Paramasa dhe parallogaria) – Vlera: 244,817.20 €.
- Projekti “Parku Lagjja e Morinëve” (Projekt i detajuar) –Vlera e parashikuar: 345,313.83€.
- Projekti “Parku te banesat Sociale dhe parku në rrugën Adem Jashari” –Vlera: 199,977.90€.
- Projekti “Parku te banesat e kuqe dhe parku te banesat Sociale” – Vlera: 55,626.80 €.

- Projekti “Pastrimi i lumenjve” – Është përgatitur projekti teknik dhe i është dorëzuar drejtorisë.

Drejtoria e Arsimit (DKA):

- Projekti “Renovimi i objekteve shkollore” (Çerdhja “Rrita jonë”-Obiliq, shkolla “Dosidej Obradovic”-Palaj, shkolla “Migjeni”-Grabovc dhe shkolla “Fazli Graiçevci”-Hade e re) – Vlera e projektit: 178,153.17 €.

Drejtoria e Shëndetësisë:

- Projekti “Renovimi i Ambulancave në fshatrat Mazgit dhe Dardhishtë” (Paramasa dhe parallogaria) – Vlera: 82,258.40 €.

Drejtoria e Kulturës:

- Projekti “Instrumente Muzikore për Shtëpinë e Kulturës Xhavit Haziri” (Paramasa dhe parallogaria) – Vlera: 20,000.00 €.

Drejtoria e Bujqësisë:

- Projekti “Shtalla e lopëve 5 krerë” (Projekt teknik i dorëzuar) – Vlera e parashikuar: 39,939.83 €.

Vlera Totale e Projekteve të Përgatitura (Gati për Inicim): 1,788,477.26 €

PROJEKTET E BARTURA (Nga viti paraprak)

Kjo pjesë përfshin projektet që janë në proces të realizimit, por që nuk kanë përfunduar sipas planit të vitit të kaluar. Projektet e shënuar në tabelë janë projekte të cilat janë bartur për shkaqe kryesishtë buxhetore, por edhe për shkak të komplikimeve dhe pengesave të paparashikuara me projekt.

Emri i Projektit	Statusi Aktual	Arsyetimi i vonësës	Përqindja e realizuar
Asfaltimi i rrugëve rurale në fshatin Mazgit	Përfunduar	Në këtë projekt vonesat janë bërë për dy arsye: 1. Për shkak të punëve të pa parashikuara në teren. 2. Për shkak të buxhetit (përmbauesit)	100%
Ndëritmi i dy nënkalimeve në Obiliq	Në proces të punës	Në këtë projekt vonesat janë bërë për dy arsye: 1. Gjatë punimeve kanë dal punë të paparashikuara për shkak të infrastrukturës nëntokësore. 2. Probleme me buxhet (Përmbauesi)	Në bazë të buxhetit: 72% Vlera e Kontratës: 445,838.01 € Pagesat: 320,172.61 €

PROJEKTET NË FAZËN E PLANIFIKIMIT (Vizitat në terren)

Këto projekte përfaqësojnë nevojat e identifikuar direkt nga terreni dhe kërkesat e qytetarëve, të cilat janë në proces të vlerësimit fillestar.

Identifikimi i nevojave: Janë realizuar vizita në fshatra dhe lokacione të ndryshme në komunën tonë.

Vlerësimi teknik: Për këto projekte janë hartuar raportet e shkurtra të vizitave ku specifikohen kërkesat dhe nevojat, gjatësia/sipërfaqja dhe rëndësia e investimit.

Tabela më poshtë paraqet vizitat në fshatra sipas kërkesës dhe nevojës së qytetarëve:

DIL		
Nr	Emri i Projektit	Profili inxhinierik
1	Mazgit Rr. Çlirimi seg1 L=65m, B=3m	Rrugë
2	Mazgit Rr. Çlirimi seg2 L=30m, B=3m	Rrugë
3	Mazgit Rr. Çlirimi seg3 L=66m, B=4m	Rrugë
4	Mazgit Rr. Çlirimi seg4 L=40m, B=3m	Rrugë
5	Mazgit Rr. Çlirimi seg5/1 L=23m, B=3m	Rrugë
6	Mazgit Rr. Çlirimi seg5 L=91m, B=3m	Rrugë, Kanalizim, Ujësjiellës
7	Mazgit Rr. Çlirimi seg6 L=170m, B=3m	Rrugë
8	Mazgit Rr. Çlirimi seg7 L=36m, B=3m	Rrugë
9	Mazgit Rr. Çlirimi seg8 L=98m, B=3m	Rrugë
10	Mazgit Rr. Çlirimi seg9 L=19m, B=3m	Rrugë
11	Mazgit Rr. Çlirimi seg10 L=34m, B=3m	Rrugë
12	Mazgit Rr. Dita e flamurit seg1 L=25m, B=4m	Rrugë
13	Projekti për Çiçavic	

Në kuadër të planifikimit kemi dalë në terren edhe me Drejtoritë tjera ku kemi bërë vizita të ndryshme dhe në kuadër të punës me drejtori tjera do të paraqes edhe emrin e projektit si aktivitet gjatë periudhës 6 mujore.

DSHPE		
Nr	Emri i Projektit	Profili inxhinierik
1	Projekti për Mirëmbajtje Rrugore	Ndërtim, Renovim
2	Projekti për renovimin edhe mobilimin e shtëpisë për të pame në Llazarevë dhe Mazgit.	Renovim
3	Projekti për Stacion të Autobusave	Arkitekturë dhe Ndërtimtari

Në kuadër të kësaj drejtorisë kam bërë edhe shumë aktivitete të cilat hyjnë në kuadër të drejtorisë së DSHPE-së:

1. Formimin e linjave të reja për transportin urban publik,
2. Formimin e itinerareve dhe kohës së lëvizjeve nga pika A në B pra nga vend nisja deri në destinimin e fundit në Prishtinë.
3. Evidentimi i kilometrave të linjave dhe nisjeve për shkak të kostos së subvencioneve të transportit. etj.

PROJEKTET E PROJEKTUARA (Përmes kompanisë së projektimit)

Projektet që kanë kaluar fazën e idesë dhe tani posedojnë plane të detajuara ekzekutive, paramasa dhe parallogari.

Projektet e kompletuara me të gjitha detajet teknike, gati për procedim në prokurim.

Nr	Emri i Projektit	Profili inxhinierik
1	Plemetin Rr. Sokoli seg 1 L=270m	Rrugë
2	Plemetin Rr. Sokoli seg 2 L=193m	Rrugë
3	Plemetin Rr. Sokoli seg 4 L=207m	Rrugë
4	Plemetin Rr. Sokoli seg 3 L=280m	Rrugë
5	Plemetin Rr. Sokoli seg 6 L=207m	Rrugë
6	Plemetin Rr. Sokoli seg 5 L=107m	Rrugë
7	Plemetin Rr. Sokoli seg 7 L=173m	Rrugë
8	Plemetin Rr. Sokoli seg 8 L=200m	Rrugë
9	Plemetin Rr. Sokoli seg 9 L=100m	Rrugë
10	Plemetin Rr. Sokoli seg 10 L=91m	Rrugë
11	Plemetin Rr. Bregajve seg 1 L=268m	Rrugë, Kanalizim
12	Obiliq Rr. Shaban Polluzha seg1 L=132m B=5m	Rrugë
13	Sibovc Rr. Musli Gashi Seg 2L=60m B=3m	Rrugë
14	Sibovc Rr. Musli Gashi Seg1 L=120m B=3m	Rrugë
15	Sibovc Rr. Musli Gashi L=158m B=3m	Rrugë
16	Sibovc Rr. Musli Gashi Seg 3 L=67m B=3m	Rrugë
17	Sibovc Rr. Musli Gashi Seg 1L=132m B=3m	Rrugë
18	Sibovc Rr. Musli Gashi L=85m B=3m	Rrugë
19	Sibovc Rr. Gjasht Vëllëzrit L=134m B=3m	Rrugë
20	Rruga: Plemetin-Hamidi-Siboc	Rrugë, Shteg për biçikleta, Trotuar, Ndriçim
21	Rruga: Breznicë – Kozaricë (Rruga kryesore)	Rrugë, Shteg për biçikleta, Trotuar, Ndriçim
22	Projektimi i Objektit të QKMF-së	
23	Stadiumi për Futboll të madh në Milloshevë	
24	Rindërtimi i Fushës së futbollit në Raskovë	
25	Ndriçimi Publik dhe vendosja e kamerave në Haden e Re	

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN,PRONË,KADASTËR DHE GJEODEZI

Drejtoria e DPUPK është e ndarë në katër sektore, sektori i Urbanizmit, Pronës dhe Çështjeve pronësore juridike, Kadastrit dhe Gjeodezisë, ku secili nga këta sektorë është i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme. Të gjithë sektorët janë duke i përmbushur me përkushtim të plotë duke i respektuar normativat ligjore në fuqi dhe afatet ligjore, duke u ndarë të knaqur edhe me qytetarët edhe me vetë eprorët që vazhdimisht raportojnë për punët e përfunduara dhe ato të cilat janë në proces të përfundimit.

Kështu që puna e kryer gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2026 ka qenë një punë produktive të cilën do t'a paraqesim në vijim :

-SEKTORI I PRONËS-

Gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2026 **Sektori i pronës** dhe çështjeve pronësore juridike në kuadër të DPUPK-së ka qenë e ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që janë paraparë të kryhen e të cilat do t'i paraqesim në vazhdim :

Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër me iniciativën e Kryetarit të Komunës me dt. 12.06.2026 ka përgaditur dy Propozimvendime për aprovim në Kuvendin Komunal përmes së cilave është bërë shpallja e interesit të përgjithshëm Publik ndaj dy njësive kadastrale në zonën kadastrale Obiliq të cilat aktualisht janë nën menaxhimin e AKP-së e të cilat më vonë Komuna synon që t'i shpronësojë dhe në të njëjtat të realizoj projekte në dobi të qytetarëve tanë.

Vlenë të theksohet se për shkak të vëllimit të madh të punës dhe kërkesave të shumëta nga ana e qytetarëve që kanë parashtruar në Drejtorinë e Planifikimit Urban , Pronë dhe kadastër, një pjesë e stafit të Drejtorisë është angazhuar të punojë edhe ditëve të vikendit në mënyrë që të përfundojë rreth 250 lëndë për bartjen e pronës në emër të KEK-ut . Sa për informim këto prona kanë qenë në emër të pronarve privat të cilat gjenden në zonat kadastrale: Hade, Siboc dhe Leshkoshiq të cilat janë formalizuar në mes të KEK-ut dhe pronarëve te noteri dhe në këto prona për interes nacional është shtrirë fusha e mihjes së Qymyrit për nevojat e KEK-ut. Pra , fal angazhimit dhe kontributit të stafit të Drejtorisë ky proces në kohë optimale ka përfunduar me sukses.

Gjatë gjashtë muajorit të parë të vitit 2026 kemi pas kërkesa të lëndëve të ndryshme të cilat bien në kuadër të fushë veprimtarisë së DPUKP-së dhe atë si në vijim:

<i>1.Kontratë e Shitblerjes</i>	<i>185</i>
<i>2.Kontratë për Ndarjen e Paluajtshmërisë</i>	<i>00</i>
<i>3.Aktvendim i Trashëgimisë</i>	<i>39</i>
<i>4.Regjistrim i Hipotekës</i>	<i>28</i>
<i>5.Fshirje e Hipotekës</i>	<i>11</i>
<i>6.Kontrata të Faljes (Dhurimit)</i>	<i>160</i>
<i>7.Parcelizim (Ndarje)</i>	<i>81</i>
<i>8.Bashkim Parcelave</i>	<i>38</i>
<i>9.Rregullim i Kufijve</i>	<i>1</i>
<i>10.Regjistrim i Objektivit</i>	<i>00</i>
<i>11.Regjistrim Shpronësimi</i>	<i>12</i>
<i>12.Modifikim për Person</i>	<i>51</i>
<i>13.Vendime Gjyqësore</i>	<i>00</i>
<i>14.Kontrata të Qiramarrjes për 99 vite</i>	<i>2</i>
<i>15.Kontrata të Këmbimit (Ndërrimit)</i>	<i>1</i>
<i>16.Historiat i Pronës</i>	<i>6</i>
<i>17.Regjistrim i Barrës Tatimore</i>	<i>4</i>
<i>18.Vendime për mbajtje të Përjetshme</i>	<i>1</i>
<i>19.Lirim nga Barra Tatimore</i>	<i>3</i>
<i>20.Urdhër nga Përmbaruesi</i>	<i>1</i>
<i>21.Marrëveshje Ndërjetësimi</i>	<i>5</i>
<i>22.Regjistrim i Vërejtjes gjyqësore</i>	<i>2</i>
<i>23.Fshirje e Vërejtjes Gjyqësore</i>	<i>00</i>

Raporti Gjashtë mujori i parë-2026			
	çertif.paluaajtshmerisë	Kopje plani	çert.gjendj pronësore
kerkesa	872	839	391
te realizuara	828X2	812X2	56X1
procedur	0	0	0
me bllok	4	3	0
lirume	40	24	335
totali	1656€	1626€	56€
totali I pergjthshem	3338€		

Te Hyrat Janar-Qershor 2026 në Sektorin e Gjeodezisë Pronë dhe Kadastër janë: 19,817€ + 3338 € Cert.paluaajtshmerisë , Kopje Plani dhe Cert.gjendje pronësore , Gjithsejt të hyra = 23,155 € .

-Numri i Bartjes së Pronës në emër të dy Bashkëshortëve ka qenë 20 ;

-Numri i Bartjes së Pronës në emër të Meshkujve 278 dhe;

- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Femrave 38 .

-SEKTORI I KADASTRIT-

- Si piknisje Sektori i Kadastrit kujdeset për respektimin e ligjeve dhe mbanë përgjegjësi për ligjet e Kadastrit dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga AKK, dhe se bashku me t'a krijojnë metoda në avansimin e punës.

- Gjatë periudhës Janar-Qershor 2026 kemi punuar në realizimin e të gjitha kërkesave për qytetarët e Komunës, varësisht prej llojit dhe natyrës së kërkesave të qytetarëve.

- Zhvillimin e procedurave të regjistrimit , sipas detyrës zyrtare dhe kërkesës së palëve;

- Korigjimin e regjistrit (SIKTK-së) sipas procedurave dhe zbatimin e të gjitha dispozitave ligjore në fuqi;

- Regjistrimin e pronave të paluajtshme ;

- Azhurimin e pronave ,në bazë të dokumentacionit të lëshuara nga Gjykatat, Noterët, Përmbauesit si dhe organet përgjegjëse Vendimet e Kuvendit, Vendimet nga AKK si dhe vendime tjera etj;

- Zbatimin e procedurave rreth transaksioneve të pronave private në SIKTK ;

-Evidentimin dhe shlyrjen e masave të përkohshme sipas aktvendimit të Gjykatës kompetente;

- Udhëheqjen me kadastrë etazhë të banesave ,ndërtesave , pjesëve të ndërtesave si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë ndërtuar banesat;

- Regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave ; Aktvendimeve mbi regjistrimin e servituteve, regjistrimin e barrave tatimore;

- Lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmëri, certifikatave mbi të drejtat e pronës së paluajtshme si dhe kopje planit;

- Mirmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve ,fshatrave ,shesheve,rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;

- Nxerrjen e aktvendimeve për miratim e ndarjeve të parcelave, Legalizimin e ndërtesave bashkimin e parcelave modifikimin e atributëve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave;

- Nxerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara;

- Përgaditjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin punës;

- Punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore(kërkesat për nevojat e gjykatave dhe institucioneve tjera).

- Zhvillimin dhe organizimin e sistemeve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale , modelin e sistemit informatik për tokën dhe pronën;

- Regjistrimin e ndarjeve të parcelave dhe modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.

- Kryrjen e punëve profesionale , të cilat dalin nga shërbimi gjeodezik (ndryshimet e bëra gjatë matjeve nga Hartat e Kosovës dhe bartjen e tyre në programin e SIKTK-së.

- Kryrjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhënien e kordinatave për teren) dhe;

- Si dhe Shërbime profesionale dhe shërbime të tjera ,për subjekte dhe institucione të ndryshme.

Në përfundim të këtij raporti për periudhën Janar-Qershor 2026 konstatojm se kemi arrit t'i përfundojmë varësisht prej natyrës së lëndëve, Kontrata shitblerje, Kontrata Falje, Kontrata per ndarje fizike, Regjistrim të Hipotekave Fshirje të Hipotekave, Aktvendime nga MMPH-ja, Vendime te Ndërmjetësuesëve, Aktvendime të Trashigimisë, Aktvendime të Gjykatës, Masë të Sigurisë nga Gjykata, Regjistrim të barra tatimore, ndarje të parcelave, Legalizimin e ndërtesave ,Bashkimin e parcelave, modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave Vendime të ndryshme, Kërkesa të ndryshme, Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Kopje Plani , Çertifikata që nuk posedojnë Pronë duke ardhur në përfundim se gjatë periudhës Janar-Qershor 2026 kemi relizuar gjithsejt 2102 kërkesa.

-SEKTORI I GJEODEZISË-

Raporti përmban një përmbledhje në vija të trasha të punëve gjatë periudhës Janar-Qershor për vitin 2026. Në raport janë përfshirë punët e përfunduara nga sektori në aspektin profesional sipas kërkesave të parashtruara nga ana e Drejtorive të KK Obiliq të cilat lidhen drejtpërdrejtë me punë profesionale në teren e që janë situacione të ndryshme për nevoja të projektimit,matje të parcelave – kufijëve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve,elaborate të shpronësimit dhe identifikime të ndryshme me matje.

Pasqyra e lëndëve të përfunduara në kuadër të mirëmbajtjes së rregullt të Kadastrit do të paraqitet me një tabelë të veçantë dhe do t'i bashkangjesim këtij raporti ndërsa ky raport me shkrim do të përfshijë vetëm punët dhe shërbimet që janë kryer sipas kërkesave të Drejtorive brenda Komunës.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2026 është punuar në legalizimin e objekteve sipas Ligjit për legalizim,objektet të cilat marrin Vendimin për Çertifikatë të Legalizimit regjistrohen

në pjesën grafike dhe tekstuale të Kadastrit, në këtë proces janë legalizuar objekte në bazë të Vendimit për Certifikatë të Legalizimit gjithsejt sipas zonave kadastrale me sa vijon:

- zk Krushevc.....1 (një) objekt
- zk Mazgit.....1 (një) objekt
- zk Milloshevë.....4 (katër) objekte
- zk Obiliq.....1 (Një) objekt
- zk Plemetin.....1 (një) objekt
- zk Raskovë.....2 (dy) objekte

Gjithsejt **10 objekte** të regjistruara në kadastër në procedurë të legalizimit dhe procedurë të rregullt në bazë të lejes ndërtimore dhe aktvendimit për certifikatë të përdorimit.

Lëndët e punuara në pjesën grafike në mirëmbajtjen e rregullt të kadastrit.

Pasqyra vjetore e lëndeve nga Regjistri i Fletëparaqitjes Janar-Qershor 2026							
Zona Kadastrale	Ndarje	Bashkim	Shpronësim	Korigjim Kufirit	Identifikim-Azhurim	Ndërtesa	Total
Babimoc	7	3	1	-	1	-	12
Bakshi	6	2	-	1	-	-	1
Breznicë	-	1	-	-	-	-	1
Caravodicë	1	1	-	-	-	-	2
Graboc i Epërm	2	1	-	-	-	-	3
Hade	-	-	-	-	-	-	0

Hamidi	2	-	-	-	-	-	2
Kryshevc	1	2	-	-	2	1	6
Leshkoshiq	2	1	-	-	-	-	3
Llazarevë	2	1	-	-	-	-	3
Milloshëvë	27	10	-	1	3	4	45
Mazgit	10	3	1	-	2	1	17
Obiliq	24	14	-	-	-	1	39
Plemetin	15	6	-	-	-	1	22
Raskovë	5	-	-	-	-	2	7
Siboc	7	2	-	-	-	-	9
Shipitullë	4	-	-	-	-	-	5
Total	115	47	2	1	9	10	184

-SEKTORI I URBANIZMIT-

-Brenda periudhes Janar-Qershor të vitit 2026 sektori i **Urbanizmit** në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor.

Në këtë periudhë atëherë volumi i aplikimeve për t'u paisur me leje ndërtimore ka qenë mjaft i lartë, andaj sektori i jonë me tërë kapacitetin është munduar që t'iu përgjigjet kërkesave qoftë për kushte ndërtimore, leje ndërtimore apo kërkesave të qfarëdo qoftë natyre që i përkasin sektorit.

-Raportimi i vazhdueshëm dhe përgjegjësia lidhur me auditimin e lëndëve si me auditorët e jashtëm ashtu edhe me auditorët e brendëshëm, pasi udhëheqësi i sektorit të Urbanizmit është pëfaqësues i drejtorisë për të gjitha sektoret për takimet me auditor dhe dhënien e informatave.

-Janë kryer edhe punë të tjera që janë të lidhura me sektorin e urbanizmit, duke cekur edhe konsultimet me palë lidhur me punët që i takojnë natyrës së punës tonë.

-Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.

- 18 vendime për leje ndërtimore,
- 2 certifikata të përdorimit,
- 6 vendim të refuzimit,
- 2 leje rrënimi,
- 5 pelqim
- 8 përgjigjeje palëve,
- 3 njoftime për qytetarë në kërkesat e ndryshme.
- 3 informate për palëve

- 13 vendime të legalizimit të objekteve

- 8 vendime të legalizimit për listë të pritjes.

Të hyrat nga lejet ndërtimore : 51678.31€

Të hyrat nga legalizimi i objekteve: 2565.05 €

T O T A L 54 243.36 €

Sektori i Urbanizmit :	54 243.36 €
Sektorët - Gjeodezi Pronë dhe Kadastër :	23,155 €
Totali :	77,398.36€

NJËSIA E BURIME NJËROZORE

Duke u mbështetur në planifikimin e burimeve njerëzore Njësia e Burimeve Njerëzore ka për qëllim zbatimin e planit të punës.

Plani i punës për vitin 2026 përmban bazën ligjore, strukturën organizative të Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNJ), detyrat, përgjegjësit objektivat të cilat realizohen përmes aktiviteteve, indikatorëve, përgjegjëseve dhe afateve kohore. Kjo mundëson zbatimin më të lehtë të këtij plani dhe monitorimin e tij.

Gjatë muajit Janar / Qershor - 2026 kemi zhvilluar këto procedura :

- Planifikimi i personelit për vitin 2026.
- Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2025
- Udhëheqësit e sektoreve nuk janë vlerësuar
- Zyrtarët në Kabinetin e Kryetarit të Komunës nuk janë vlerësuar
- Zyrtarët në Drejtorinë e Administratës nuk janë vlerësuar
- Zyrtarët në Drejtorinë Mbrojtje të Mjedisit nuk janë vlerësuar
- Zyrtarët në Drejtorinë për bujqësi nuk janë vlerësuar
- Zyrtarët në Drejtorinë për Shendetësi / Administrat nuk janë vlerësuar
- Zyrtarët e shërbimit social në QPS nuk janë vlerësuar

Auditimi i Brendshëm-

- Gjatë Auditimit të brendshëm kanë audituar lëndët për të gjithë të punësuarit në SHF”Sveti Sava”në Plemetin, SHF”Milan Rakiq” në Baimoc dhe për SHF”Dositej Obradoviq” në Palaj.

Zyra për Inegrimë Evropjane

Duke e ditur rëndësinë e procesit të integritimeve evropiane dhe fuqizimit të rrugëtimit të Kosovës drejt këtij procesi, si dhe me qëllim të harmonizimit të veprimeve dhe koordinimit të aktiviteteve ndërmjet Komunave, Ministrisë së Integritimeve Evropiane, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Punëve të Brendshme kam kryer raportim të rregullt në periudh një mujore, tre mujorë, gjashtë mujor, nëntë mujor, një vjetorë si dhe sipas nevojës dhe kërkesës nga Ministrit e linjës raport mujor apo add-hoc raport në koordinim me Kryetarin e Komunës, Drejtorët Komunal, departamentet e

caktuara për koordinim, për zbatimin e detyrave të komunës që dalin nga Plani i Veprimit për Partneritet Evropian.

Zyra për Integrim Evropian në komunën e Obiliqit bashkëpunon ngushtë me Agjencinë për Integrim Evropian (AIE) për qëllime të bashkërendimit të aktiviteteve në kuadër të procesit të Integrimit Evropian.

Në janar me kërkesën e Asociacionit të komunave kemi mbajtur takimin e rregull të Kolegjiumit të zyrtarëve për integrim evropian, me qëllim të shqyrtimit të planit të punës, si dhe përcaktimin e aktiviteteve në kuadër të koordinimit dhe zhvillimit të veprimtarisë të kolegjiut.

Duke e ditur rëndësinë e procesit të integrimit evropian dhe rrugëtimit të Kosovës drejt BE-së, si dhe me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, harmonizimit të veprimeve dhe koordinimit të aktiviteteve me komunat, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkë organizim me Ministrin e Integrimit Evropian, kemi marr pjesë në punëtorinë ku prezantohen mundësitë për financim nga programet e BE-së.

Takimin e kolegjiut për integritime evropiane kemi rishikuar planin e punës 2026 dhe kemi marr informacione për raportin e fundit kombëtar ku prej 38 komunave të Republikës së Kosovës Komuna e Obiliqit si gjithë here është nder me te mirat në përmbushjen e standardeve, po ashtu propozohet formimi i planin për mbrojtjen e trashëgim kulturore, plani integritetit është në vitin e fundit qe duhet të bëhen ndryshime, keto pune janë në proces dhe do te përfundoj me kohe etj, ku kam biseduar me zyrtarë të kulturës, administratës e kuvendit dhe me kanë premtua qe brenda vitit do te kryhet

Në qershor me kërkesë nga IKAP-i kam marr pjese në një trajnim dy ditor me temën: Integrimi i të huajve.

ZYRA LIGJORE

Zyra ligjore për periudhen e parë të vitit 2026 paraqet këtë raport të punës:

Shërbimet ligjore të ofruara:

Këshilla juridike: për zyren e Kryetarit, drejtoritë komunale, sektoret, zyrën e personelit në përpilimin e akteve juridike, vendime, rregulloret komunale të aprovuara në kuvend sipas propozimeve të drejtorive.

Përpilimin e kontratave ,memorandumeve për zyrën e kryetarit dhe për të gjitha drejtorite, përpilimin e shkresave të ndryshme etj.

Shqyrtimin e kontratave të propozuara nga ana e drejtorive për bashkëpunim me organizatat e ndryshme para se të bëhet nënshkrimi i tyre.

Përpilimin e vendimeve sipas kërkeses se Kryetarit dhe Drejtorive.

Përfaqësimet :Në bashkëpunim me Zyrtaret Ligjore dhe avokatin janë bërë mbi 153 veprime juridike –gjyqësore duke përfshirë Padite, shkresa, përgjigje në padi, parashtrësia të ndryshme për gjykatë, mbajtje të seancave gjyqësore si dhe sigurim të provave sipas kërkesës së gjykatave, prapsime tek permbaruesi menaxhimi i kontratës dhe shume veprime tjera.

Pranimi i të gjitha lëndëve gjyqësore përmes arhivës, shqyrtimin e tyre, regjistrimin në regjister të evidences si dhe kompletimin e lendeve per ti dorëzuar tek avokati.

Përgatitja e raportit për shpenzime kontigjente për vitin 2026 të bartura nga viti 2025, në këtë raport nuk janë përfshirë kontestet të cilat nuk ju dihet vlera deri ne marrjen e ekspertizes si dhe kontestet pronesore qe kanë të bëjnë me vërtetim prone.

Poashtu në këtë vitë si zyre ligjore kemi punuar ne hartimin e listes së lëndëve gjyqësore të ndara në llojet e ndryshme të kontesteve duke pëfshire me gjeresisht Kontraten Kolektive te Arsimit.

Ky raport ka përshire lëndet gjyqësore të përfunduara dhe njëkohesisht të paguara nga DEFZH gjithësej 168 lënd dhe të viti 2025 dhe poashtu lëndët të cilat janë të përfunduara me verdikt gjyqësor por të njejtat nuk jane paguar, si dhe te gjitha lëndet të cilat janë në procedure gjyqesore.

Pjesmarrje ne takimet e rregullta të kolegjiut të zyrtarëve ligjor në kuadër të Asociacionit të Komunave të Rrepublikës së Kosovës

Hartimi i raportit për shpenzime kontigjene për DEFZH dhe auditorin gjeneral.

Këshilla për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhezimeve administrative të cilat vijnë nga niveli qendror,sipas kërkesave të drejtorive .

Pjesmarrje në mbledhjet e Kuvendin e Komunes sipas kërkesës së sekretarisë së Kuvendit dhe me kryesuesen bëjmë përpilimin e akteve të ndryshme nga fushëveprimtaria e Kuvendit Komunal.

- Takime të rregullta me Avokatin e Komunës, bashkëpunim dhe koordinim të punës në çështjet gjyqësore, përpilimin e përgjigjeve në padi dhe shkresa tjera, sigurimin e provave nga ana e drejtorive përgjegjëse për secilën lëndë që i përket atyre, pjesmarrje në seanca gjyqësore dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me të gjitha lëndët gjyqësore në cilësinë e palës paditëse dhe të paditur.

ZYRA E PROKURMI

Nr .	EMRI I LENDES	NUMRI I PROKURIMIT	VLERA E PARASHIKUAR	VLERA E KONTRAKTUAR	DATA E INICIMIT	PLANI DINAMIK	NENSHKRI MI I KONTRATES	Operatori Ekonomik
1	Shtruarja e Rrugëve me Zhavor	614-25-11425-5-2-1	30,000.00	30,000.00	19/12/2025	1MUAJ	11/2/2026	BENI COM
2	Blerja e Uniformës për Inspektorët e Drejtorisë së Inspektionit	614-26-262-1-4-7	9/23/1902	985.00	30/01/2026	15 dite	3/2/2026	Driton Tahiri B.I
3	Intervenime Emergjente në Shkolla	614-26-223-5-3-6	9,799.62	4,377.40	27/01/2026	15DITE	19/02/2026	ZON SOLUTION
4	Shërbimet e byfes për Komunën e Obiliqit	614-26-390-2-3-6	9,900.00	9,840.70	46,144.00	6 muaj	1/4/2026	D.P.H. "IN - GOJ",
6	Ri-tender- Ndërimi I bravave elektrike dhe konfigurimi I access kontrollave në objektin e komunës	614-26-2229-1-4-7	620.70	614.70	15/04/2026	7 dite	20/04/2026	KASTRATI TECH SH.P.K.
7	Renovimi i shkollës SHFMU- Dr.Ibrahimi Rugova - Punimi i Dyshemes në	614-26-1292-5-2-1	19,881.50	17,377.00	16/03/2026	15DITE	22/04/2026	Rexha

	sallën sportive me Vinyl Heterogjen							
8	Dita e tokës (Blerja e Maicave)	614-26-2623-1-4-7	999.00	985.00	22/04/2026	2	24/04/2026	N.T.SH." CREATIVE DESIGN "
9	Finalizimi I Shtëpive për Komunitete	614-26-2663-1-3-6	7,160.00	5,910.00	23/04/2026	30dite	20/05/2026	Archi-D Projekt
10	Furnizim me material administrativ për QKMF-Obiliq.	614-26-2182-1-3-6	3,000.00	1,312.97	14/04/2026	30	5/7/2026	AGIMI DE SH.P.K.
11	Ritender-Furnizim me mbulesa për fëmijë grup-mosha 9 muaj deri ne 2 vite-Qerdhja në Mazgit dhe Milloshevë	614-26-3325-1-4-7	950.00	950.00	8/5/2026	2	13/05/2026	Emine Haziri BI
12	Ritender-Furnizim me mbulesa për fëmijë grup-mosha 2 deri ne 5 vite-Qerdhja në Mazgit dhe Milloshevë	614-26-3328-1-4-7	960.00	960.00	8/5/2026	2	13/05/2026	Emine Haziri BI
13	Furnizim me material Higjenike për Institucionet Arsimore dhe Shëndetësore	614-26-963-1-2-1	34,016.70	15,555.50	24/03/2026	30dite	13/05/2026	" KIGA " SH.P.K.

14	Furnizim me lule për manifestime solemne dhe përkujtimore	614-26-2468-1-3-6	3,000.00	2,450.00	20/04/2026	12muaj	12/5/2026	Lulishtja Labi-A
15	Finalizimi I Shtëpive për Komunitete	614-26-2663-1-3-6	7,160.00	5,910.00	23/04/2026	1 muaj	20/05/2026	Archi D projekt SH.P.K
16	Ndërtimi I QKMF-së në Obiliq- Faza e parë	614-26-3916-5-2-1	384,449.70	369,934.31	22/05/2026	3 muaj	1/7/2026	Grup i Operatorëve Ekonomik ENG GEO GROUP SH.P.K.; ARBËRI -NS SH.P.K.
17	Furnizim me oksigjen medicinal	614-26-4192-1-3-6	3,820.00	3,816.00	3/6/2026	12muaj	29/06/2026	MESSER MEDICA L.L.C.
18	Furnizimi me Tepiha per koridoret të Çerdhes në Millosheve dhe Mazgit	614-26-5082-1-4-7	920.00	920.00	24/06/2026	2 dite	29/06/2026	Bajram I. Krasniqi B.I.
19	Furnizimi me Tepiha per klasë të Çerdhes në Millosheve dhe Mazgit	614-26-5193-1-2-1 1	920.00	920.00	25/06/2026	2 dite	29/06/2026	Bajram I. Krasniqi B.I.

Zyra e projekteve

Gjatë periudhës shkurt – qershor 2026, janë realizuar detyrat administrative dhe profesionale në kuadër të Zyrës së Projekteve, në koordinim me Shefin e Kabinetit dhe sipas udhëzimeve të Kryetarit të Komunës. Fokusi kryesor i angazhimit ka qenë zhvillimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare, identifikimi i mundësive të financimit, përgatitja e aplikimeve për projekte, si dhe ofrimi i mbështetjes institucionale në proceset zhvillimore të komunës.

Arritjet kryesore

Bashkëpunimi ndërkombëtar

- Janë iniciuar dhe zhvilluar kontakte me mbi 30 ambasada, organizata ndërkombëtare dhe donatorë, me qëllim sigurimin e fondeve dhe krijimin e partneriteteve strategjike.
- Janë zhvilluar takime zyrtare me UNDP, GIZ, KFOR, EULEX, Qatar Charity, Concordia, ALDA, Play International, Caritas Kosovo, Four Paws, UN Women.
- Janë vendosur komunikime me komuna dhe institucione në Norvegji, Luksemburg, Belgjikë, Holandë, Itali, Japoni dhe vende të tjera për mundësi bashkëpunimi në lidhje me autobusët dhe kamionë.

Projekte dhe aplikime

Gjatë kësaj periudhe kam kontribuar në:

- Përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit në ReLOaD3 – Pilot Projekti për Mbështetje Teknike Profesionale.
- Aplikimin në UNMIK për projektin multisport në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.
- Përgatitjen e aplikimeve në kuadër të MZHR-së për dy projekte komunale.
- Përgatitjen e aplikimit për pilot projekt dhe me dy projekte Lumi Drenica dhe Restuarimi i prrockave Siboc, Bakshi dhe Plemetin në kuadër të Skat Consulting – Integrated Water Resources Management in Kosovo.
- Koordinimin e përgatitjeve për aplikim në Canada Fund. Kemi aplikuar me qendrën rinore të komunës së Obiliqti ku janë refuzuar dhe nuk janë përzgjedhur në këtë projekt
- Mbështetjen teknike për bizneset lokale në aplikimet në Programin për Zhvillim të Balancuar të MZHR-së.

Përfaqësimi institucional

Komuna është përfaqësuar në takime dhe aktivitete me institucione, ambasada, organizata ndërkombëtare dhe partnerë zhvillimorë, përfshirë:

- Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- Ambasadën e Republikës së Sllovenisë;
- KFOR-in;
- EULEX-in;
- GIZ-in;
- UNDP-në;
- Qatar Charity;
- Concordia, në kuadër të diskutimeve për krijimin e një qendre sociale dhe identifikimin e objektit të përshtatshëm;
- Four Paws;
- organizata dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë.

Gjatë këtyre takimeve është ofruar mbështetje profesionale në koordinimin institucional, komunikimin me partnerët ndërkombëtarë, si dhe përkthim zyrtar sipas nevojës për Kryetarin e Komunës, drejtoritë komunale, delegacionet ndërkombëtare, KFOR-in, Ambasadën e Japonisë dhe organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare.

Komunikimi me donatorët

Janë përgatitur dhe dërguar dhjetëra shkresa zyrtare dhe email-e drejt ambasadave, organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare për:

- krijimin e partneriteteve;
- sigurimin e fondeve;
- zhvillimin e bashkëpunimeve në projekte;
- kërkesa për donacione;
- identifikimin e mundësive për investime në komunë.

Donacione dhe iniciativa të reja

Janë ndërmarrë iniciativa dhe zhvilluar komunikime për:

- sigurimin e autobusëve donacion nga qytete evropiane, për të cilët është pranuar ofertë fillestare;

- sigurimin e kamionëve për grumbullimin e mbeturinave, larjen dhe pastrimin e rrugëve, duke siguruar ofertë nga kompania Ros Roca (Spanjë) për kamionët Backloader, ndërsa është në pritje oferta nga kompania VIBTIS për kamionët Bucher CityCat;
- zhvillimin e bashkëpunimeve në fushën e energjisë, mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të ujërave, arsimit, rinisë dhe zhvillimit lokal.

Ngritja profesionale

Janë përfunduar me sukses:

- Trajnimi për Menaxhimin e Ciklit të Projekteve (ReLOaD3);
- Trajnimi për Menaxhimin e Projekteve nga UN Women;
- Punëtorja për Fondet e Bashkimit Evropian dhe Digjitalizimin;
- Punëtorja e organizuar nga Four Paws për menaxhimin e qenve endacakë;
- Trajnimi për menaxhimin e projekteve në fushën e mjedisit dhe zhvillimit.

Rezultatet konkrete të periudhës

- Janë krijuar partneritete të reja ndërkombëtare me potencial për financim.
- Janë dorëzuar mbi pesë aplikime për projekte në programe kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Janë iniciuar bashkëpunime në sektorët e arsimit, mjedisit, energjisë, infrastrukturës, zhvillimit ekonomik dhe komuniteteve.
- Është zgjeruar rrjeti institucional i Komunës së Obiliqit me mbi 30 partnerë potencialë ndërkombëtarë.
- Janë identifikuar dhe iniciuar mundësi të reja për financim dhe donacione, të cilat pritet të konkretizohen në periudhën vijuese.
- Është ofruar mbështetje administrative, teknike dhe profesionale për drejtoritë komunale në përgatitjen dhe zhvillimin e projekteve.
- Në kuadër të projektit "**Forcimi i Demokracisë Pjesëmarrëse (2025–2028)**", të mbështetur nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD3), i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UNDP, Komuna e Obiliqit është përzgjedhur si një nga komunat përfituese të mbështetjes teknike dhe mentorimit për periudhën 2026–2027.

Vlerësim përfundimtar

Gjatë kësaj periudhe është shënuar progres i konsiderueshëm në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, zgjerimin e rrjetit të partnerëve institucionalë dhe rritjen e kapaciteteve të Zyrës së Projekteve për zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve. Angazhimet e realizuara kanë krijuar një bazë të qëndrueshme për sigurimin e fondeve, realizimin e investimeve dhe zhvillimin e projekteve me ndikim në zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës së Obiliqit.